



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
Këshilli Drejtues

V E N D I M

Nr.19, datë 26.10.2017

për

Miratimin e aktit administrativ “Rregullore për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm”

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.Ina Nuellari, në mbledhjen e datës 26.10.2017, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

Miratimin e aktit administrativ “Rregullore për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm”,

BAZA LIGJORE:

1. Neni 8 (*germa d, nj, p*), neni 13 e në vijim, dhe neni 110, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
2. “Udhëzues për procedurat e këshillimit publik”, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 1183, datë 10.3.2010,

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të paraqitur si më poshtë nga Grupi i Punës,:

1. Projektvendimi për miratim të aktit administrativ “Rregullore për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm” në Këshill Drejtues, i formatuar dhe arsyetuar;
2. Relacioni shoqërues mbi dokumentin e propozuar;
3. Komentet dhe mendimet e palëve të interesuara mbi dokumentin “Rregullore për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm” dhe qëndrimi i AKEP-it për këto komente;
4. Dokumenti “Rregullore për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm”;
5. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. AKEP me Vendimin nr. 10, datë 19.04.2017, ka miratuar dokumentin “Rregullore për Autorizimin e Përgjithshëm” për këshillim publik. Ky dokument u publikua në faqen zyrtare www.akep.al me qëllim që palët e interesuara të njihen dhe të japin kontributin e tyre në lidhje me këtë Rregullore. Në zbatim të nenit 110 të ligjit nr. 9918/2008, u caktua periudha e konsultimit nga data 20.04.2017 deri më datë 19.05.2017.
2. Gjatë kësaj periudhe të këshillimit publik të dokumentit Rregullore për Autorizimin e Përgjithshëm, kanë depozituar komente sipërmarrësit si më poshtë vijon:
 - Albtelecom sh.a. depozituar me shkresë nr. 3456Prot, datë 19.05.2017 “Komente mbi draft Rregulloren për Autorizimin e Përgjithshëm”;
 - Telekom Albania sh.a. depozituar me shkresë 3374, datë 16.05.2017 “Komentet e shoqërisë Telekom Albania sh.a. mbi dokumentin për konsultim publik “Rregullore për Autorizimin e Përgjithshëm” miratuar me VKD nr. 10, datë 19.04.2017;
 - Vodafone Albania sh.a. depozituar me shkresën me Ref: LEA/050/OX, datë 19.05.2017 “Në lidhje me konsultimin publik për Rregulloren për Autorizimin e përgjithshëm” dhe shkresën Ref. LEA/080/OX, 19.9.2017, “Mbi paketën e materialeve për Rregulloren e Autorizimit të Përgjithshëm”.
3. Nga komentet e sipërmarrësve mbi dokumentin Rregullore për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm, vërehet se, është vlerësuar rishikimi i këtij dokumenti, dhe me qëllim përmirësimit të tij, palët e interesuara kanë sjellë propozimet e tyre, disa prej të cilave pas shqyrtimit nga AKEP, janë vlerësuar dhe marrë në konsideratë.
4. Në vijim të punës për finalizimin e dokumentit Rregullore për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm, AKEP u dha mundësinë palëve të interesuara, për të parashtruar mendimin në lidhje me dokumentin e propozuar pas vlerësimit të komenteve të palëve.
5. Në përfundim AKEP, pasi mori në shqyrtim dhe vlerësoi komentet e paraqitura nga sipërmarrësit, publikon qëndrimin e tij mbi komentet sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.

Nga pikëpamja ligjore projektakti është përgatitur bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, ligji 9918, i ndryshuar, dhe “Udhëzues për procedurat e

këshillimit publik”, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 1183, datë 10.3.2010,

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Këshilli Drejtues, bazuar në germën d, nj. dhe p të nenit 8, neni 13 e në vijim, nenit 114 dhe nenit 115 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Të miratojë aktin administrativ “Rregullore për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm” me anekset përkatëse sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të publikojë mendimet dhe komentet e palëve të interesuara si dhe qëndrimin e AKEP sipas Dokumentit bashkëlidhur.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij, dhe efektet e aktit “Për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm” fillojnë më datë 1 janar 2018.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Rregullore nr. 24, datë 02.02.2012 “Për Autorizimin e Përgjithshëm” e ndryshuar, së bashku me Anekset bashkëlidhur, shfuqizohet.
5. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

K R Y E T A R

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Anila DENAJ** _____
3. **Ketrin TOPÇIU** _____
4. **Klarina ALLUSHI** _____

RREGULLORE

Nr.47, datë 26.10.2017

PËR

ZBATIMIN E REGJIMIT TË AUTORIZIMIT TË PËRGJITHSHËM

Në mbështetje të shkronjës p) të nenit 8, pikës 8 nenit 14 dhe pikës 2 të nenit 15 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar,

KËSHILLI DREJTUES I AKEP

VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është që nëpërmjet zbatimit të regjimit të autorizimit të përgjithshëm të promovohet konkurrenca dhe nxitja e investimeve për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, si dhe garantimi i ofrimit të tyre në përputhje me kërkesat ligjore dhe mbrojtjen e të drejtave të pajtimtarëve dhe përdoruesve.

Neni 2

Objekti

Objekti i rregullores është përcaktimi i rregullave për zbatimin e procedurës për njoftimin e ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe përcaktimi në mënyrë të hollësishme i formës dhe përmbajtjes së:

- a) kërkesës për njoftim të dokumentacionit mbështetës;
- b) konfirmimit të regjistrimit,
si dhe,
- c) vendosja e kushteve të përgjithshme për ofrimin e rrjetit ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të njoftuara.

Neni 3

Përkufizime

1. Termat kryesore si më poshtë, të përdorura në këtë rregullore kanë këto kuptime:
 - 1.1 “*Autorizim i përgjithshëm*” është një akt i natyrës së përgjithshme, që përbëhet nga kuadri ligjor, i përcaktuar nga ligji nr. 9918 dhe rregullat e nxjerra nga AKEP-i, në zbatim të tij, për të siguruar të drejtat për ofrimin e rrjeteve dhe/ose të shërbimeve të komunikimeve elektronike,

duke vendosur edhe detyrime specifike, të cilat mund të zbatohen ndaj të gjitha ose ndaj disa prej rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.¹

- 1.2 “**Sipërmarrës**” është çdo person fizik, juridik (subjekt tregtar) i regjistruar sipas legjislacionit në fuqi, i cili ofron rrjete të komunikimeve elektronike ose shërbime të komunikimeve elektronike.²
- 1.3 “**Subjekt tregtar**” është personi fizik, sipas kuptimit të Kodit Civil, që ka cilësinë e tregtarit, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi, shoqëritë tregtare dhe degët e shoqërisë të huaja³
- 1.4 “**Subjekt**” janë subjekte tregtare dhe subjekte të tjera, të cilat, pa pasur cilësinë e tregtarit, kanë detyrimin e regjistrimit, sipas ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.⁴
- 1.5 “**Regjistrim**” është regjistrimi fillestar dhe çdo regjistrim tjetër, përfshirë dhe çregjistrimin e subjektit nga regjistri;⁵
- 1.6 “**Regjistri**” është regjistri tregtar, në të cilin regjistrohen subjektet, sipas ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar⁶
- 1.7 “**Baza e të dhënave (database)**” është regjistri i përditësuar që administrohet nga AKEP sipas pikës 9 nenit 14 të ligjit nr. 9918, për personat fizikë dhe juridikë, të cilët kanë njoftuar, sipas përcaktimeve të këtij neni.
- 1.8 “**Moduli i aplikimeve online**” është portali elektronik i AKEP, i aksesueshëm nëpërmjet faqes zyrtare në internet, që mundëson ofrimin e shërbimit në distancë, duke komunikuar drejtpërdrejt me sistemin qendror të AKEP, nëpërmjet mjeteve elektronike.
- 1.9 “**Certifikatë e Konfirmimit të Njoftimit**” është dokumenti që AKEP lëshon për konfirmimin e kryerjes së regjistrimit të Njoftimit, sipas pikës 5 të nenit 3 të ligjit nr. 9918.
- 1.10 “**Aplikues**” nënkupton çdo sipërmarrës/subjekt tregtar/subjekt sipas kuptimeve të mësipërcituara, i cili në zbatim të nenit 14 të ligjit nr. 9918 aplikon për njoftimin e AKEP sipas procedurës së përcaktuar në këtë rregullore, përpara fillimit, ndryshimit ose ndërprejjes, të ofrimit të rrjetit ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.
- 1.11 “**Rrjet i komunikimeve elektronike**” janë sistemet e transmetimit, dhe nëse ekzistojnë, sistemet e komutimit ose rrugëzimit dhe burime të tjera, përfshirë elementët e rrjetit që nuk janë aktive, të cilat lejojnë përcjelljen e sinjaleve nëpërmjet përcjellësve, radios, mjeteve optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike, duke përfshirë rrjetet satelitore, rrjetet fikse tokësore (me komutim të qarqeve ose me komutim të paketave, përfshirë internetin), rrjetet e lëvizshme tokësore, sistemet e kabllave elektrike, në rastet kur ato përdoren për transmetimin e sinjaleve, rrjetet e përdorura për transmetimet radiotelevizive dhe rrjetet kabllore televizive, pavarësisht nga tipi i informacionit të përcjellë.
- 1.12 “**Rrjet i komunikimeve publike**” është një rrjet i komunikimeve elektronike, i cili përdoret, tërësisht ose kryesisht, për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun dhe që suporton transferimin e informacionit ndërmjet pikave fundore në rrjet.
- 1.13 “**Shërbim i komunikimeve elektronike**” është shërbimi, normalisht kundrejt një pagese, i cili përftohet, tërësisht ose pjesërisht, nga përcjellja e sinjaleve përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike, që përfshin shërbimet e telekomunikacioneve dhe shërbimet e transmetimit në

¹ Pika 3, neni 3 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;

² Pika 41, neni 3 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;

³ Pika 13, neni 2 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” të ndryshuar;

⁴ Pika 12, neni 2 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” të ndryshuar

⁵ Pika 6, neni 2 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” të ndryshuar

⁶ Pika 3, neni 2 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” të ndryshuar

rrjetet e përdorur për transmetime radiotelevizive dhe në rrjetet e televizionit kabllor, por duke përjashtuar shërbimet, të cilat ofrojnë përmbajtje nëpërmjet rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, ose që ushtrojnë kontroll redaksional ndaj përmbajtjes së ofruar për transmetim, duke përdorur rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike. Ai nuk përfshin shërbimet e shoqërisë së informacionit, të cilat nuk përbëhen, tërësisht ose pjesërisht, nga përcjellja e sinjaleve në rrjetet e komunikimeve elektronike.

- 1.14 “*Shërbimi e komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun*” është shërbimi i komunikimeve elektronike, nga përdorimi i të cilit asnjë person nuk është paraprakisht i përjashtuar.
 - 1.15 “*Facilitetet shoqëruese*” janë ato shërbime shoqëruese, infrastruktura fizike dhe facilitete të tjera ose elemente të lidhura me një rrjet të komunikimeve elektronike dhe/ose një shërbim të komunikimeve elektronike, të cilat mundësojnë dhe ose mbështesin ofrimin e shërbimeve nëpërmjet këtij rrjeti dhe/ose shërbimi ose kanë potencial për ta bërë këtë, e që përfshijnë, ndërmjet të tjerash, ndërtesat ose hyrjen në ndërtesa, kabllot e ndërtesave, antenat, kullat dhe ndërtime të tjera mbështetëse, kanalizime, tubacione, shtylla, puseta dhe kabinete.
- 2 Termat e përdorur referuar shprehimisht legjislacionit të përgjithshëm, rregulloreve të AKEP, si dhe akteve apo marrëveshjeve ndërkombëtare etj., kanë të njëjtin kuptim me atë të përdorur në aktet ligjore dhe nënligjore, rregulloret apo marrëveshjet, referuese.

Neni 4

Fusha e zbatimit

1. Rregullat e përcaktuara në këtë rregullore janë të detyrueshme për tu zbatuar nga cilido sipërmarrës dhe subjekt që për qëllime fitimi parashikon të ofrojë një rrjet ose shërbim të komunikimeve elektronike kundrejt autorizimit të dhënë nga AKEP në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9918 dhe aktet nënligjore dhe rregullatore në zbatim të tij.
2. Rregullat e përcaktuara në këtë rregullore nuk janë të zbatueshme në rastet kur rrjetet dhe/ose shërbimet e komunikimeve elektronike nuk ofrohen për:
 - a) qëllimi fitimi (tregtimi) dhe kur nuk janë të disponueshme për publikun; si dhe,
 - b) përdoren vetëm për nevoja të përdorimit privat ose për nevoja të brendshme.
3. Njoftimi dhe zbatimi i procedurës së përcaktuar në këtë rregullore është i detyrueshëm edhe për subjektet e ligjit nr.97/2013 “Për transmetimet audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, (**ligji nr. 97/2013**) për të cilët ofrimi i rrjeteve për transmetimet audio dhe/ose audiovizive, kërkon përdorimin e frekuencave që administrohen nga AKEP sipas ligjit nr. 9918, ose që nuk kërkon përdorimin e frekuencave, si:
 - a) rrjetet e transmetimit kabllor;
 - b) rrjetet e transmetimit satelitor.

KREU II
REGJIMI I AUTORIZIMIT TË PËRGJITHSHËM

Neni 5
Autorizimi

1. Cilido sipërmarrës/subjekt është i lirë të ofrojë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me kërkesat e këtij ligji, kundrejt autorizimit të lëshuar nga AKEP, me përjashtim të rasteve kur rrjetet dhe/ose shërbimet e komunikimeve elektronike:
 - a) nuk ka qëllime fitimi (tregtimi) dhe kur nuk janë të disponueshme për publikun;
 - b) përdoren vetëm për nevoja të përdorimit privat ose për nevoja të brendshme të institucioneve.
2. Autorizimi për të ofruar rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë bëhet:
 - a) përmes njoftimit, kur ofrimi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike nuk kërkon përdorimin e burimeve natyrore të kufizuara;
 - b) pas njoftimit dhe dhënies së të drejtës së përdorimit, në rastin kur ofrimi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike kërkon përdorimin e burimeve natyrore të fundme (frekuenca, numeracion).
3. Sipërmarrësi/subjekti i autorizuar sipas këtyre kërkesave ligjore, ka të drejtë:
 - a) të ofrojë rrjete apo shërbime të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, sipas llojit dhe kushteve të përgjithshme të përcaktuara në këtë rregullore;
 - b) të aplikojë për marrjen e së drejtës së instalimit të faciliteteve të nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi dhe të përdorimit të tyre sipas kushteve të përgjithshme të përcaktuara në këtë rregullore.
4. Kur një sipërmarrës/subjekt i autorizuar nga AKEP, sipas këtyre kërkesave ligjore, ofron rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, atëherë autorizimi i përgjithshëm i jep të drejtë:
 - a) të negociojë për interkoneksion dhe, kur është e zbatueshme, për të marrë akses nga sipërmarrësit e tjerë të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, në përputhje me ligjin nr. 9918;
 - b) të marrë pjesë në përcaktimin si ofruer i shërbimit universal për shërbime të veçanta në skemën e shërbimit universal ose në pjesë të caktuara të territorit të Republikës së Shqipërisë.

KREU III
**PROCEDURA E NJOFTIMIT, REGJISTRIMIT DHE KONFIRMIMIT TË NJOFTIMIT,
KUSHTET E PËRGJITHSME**

Neni 6
Njoftimi

1. Përpara fillimit të funksionimit, ndryshimit osë ndërprerjes së ofrimit të rrjetit ose shërbimeve të komunikimeve elektronike për qëllime fitimi, sipërmarrësi/subjekti është i detyruar të njoftojë AKEP në përputhje me kërkesat ligjore të përcaktuara në nenin 14 të ligjit nr. 9918 dhe kësaj rregullore.
 2. AKEP, nëpërmjet një liste të përditësuar informon sipërmarrësit/subjektet e interesuar për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike të cilat mund të ofrohen sipas regjimit të autorizimit të përgjithshëm, duke zbatuar procedurën e përcaktuar në këtë rregullore. Lista e përditësuar për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike të cilat mund të ofrohen sipas regjimit të autorizimit të përgjithshëm është pjesë e kësaj rregullore sipas Aneks A.
 3. Procedura, forma dhe përmbajtja e kërkesës për njoftim të dokumentacionit mbështetës dhe konfirmimi i regjistrimit nga AKEP përcaktohen në këtë rregullore.
 4. Aplikuesi zbaton procedurën e njoftimit duke plotësuar *Formularin e Njoftimit Online* në modulën tek seksioni i aplikimeve online për Autorizim të Përgjithshëm në faqen *web* të AKEP: www.akep.al sipas formatit dhe mënyrës së përcaktuar në Aneksin B të rregullores.
 5. *Formulari i Njoftimit Online* pasi plotësohet nga aplikuesi dërgohet *online* në AKEP në adresën e përcaktuar në Aneksin B të kësaj rregullore. Një kopje e *Formularit të Njoftimit Online* e nënshkruar nga aplikuesi, së bashku me dokumentacionin shoqëruar origjinal mbi informacionin sipas pikës 2 dhe 3 të nenit 14 të ligjit nr. 9918, menjëherë me marrjen e njoftimit të pranimit të aplikimit nga AKEP, depozitohet nga aplikuesi në AKEP, dorazi ose nëpërmjet shërbimit postar.
 6. Në "*Njoftimin e Regjistrimit*", aplikuesi duhet të paraqesi detyrimisht informacionin:
 - a) emrin dhe adresën e aplikuesit/sipërmarrësit,
 - b) të dhënat e regjistrimit ligjor të sipërmarrësit në regjistër sipas ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar;
 - c) personat e kontaktit të sipërmarrësit;
 - ç) përshkrimin e shkurtër të rrjetit ose shërbimit të komunikimeve elektronike që do të ofrojë, sipas përcaktimeve të parashikuara në Aneksin B të kësaj rregullore.;
 - d) datën kur është parashikuar fillimi i ofrimit të rrjetit ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të njoftuara;si dhe çdo informacion tjetër të kërkuar në *Formularin e Njoftimit Online sipas Aneksit B*.
- Njoftimi shoqërohet me deklaratën shoqëruese sipas pikës 3 të nenit 14 të këtij ligji se,:
- e) informacioni është i saktë;
 - f) sipërmarrësi/subjekti do t'i zbatojë detyrimet ligjore.

Aplikuesi që kërkon të njoftojë ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike në tregjet përkatëse të pa rregulluara të interkoneksionit (tregu i shumicës), përveç informacionit të mësipërcituar sëbashku me kërkesën për regjistrimin e “*Njoftimit*” duhet të depozitojnë detyrimisht në AKEP edhe marrëveshjen paraprake me sipërmarrësin për shërbimet që do t’i ofrojë.

7. AKEP verifikon të dhënat e paraqitura në “*Njoftimin e Regjistrimit*” dhe nëse i gjen ato të sakta, të bazuara dhe në përputhje me kërkesat e ligjit dhe kësaj rregullore, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e pranimit të një aplikimi *online* të plotë, kryen regjistrimin e njoftimit në bazën elektronike të të dhënave (*database*) dhe i konfirmon aplikuesit me shkrim kryerjen e regjistrimit.
8. Afati ligjor i regjistrimit të njoftimit të bërë nga aplikuesi llogaritet duke filluar nga data e pranimit nga AKEP të një njoftimi të plotë. AKEP njofton aplikuesin në rrugë elektronike për pranimit e njoftimit të plotë në përputhje me kërkesat e ligjit dhe rregullores.
9. Kur informacioni për regjistrimin e një njoftimi nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 14 të ligjit nr. 9918 dhe në këtë rregullore, AKEP, brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike nga data e aplikimit *online*, njofton aplikuesin për nevojën e plotësimit/saktësimit të informacionit.
10. Aplikuesi, brenda 15 ditëve kalendarike nga data e njoftimit të AKEP duhet të paraqesë “*Njoftimin e Regjistrimit*” të plotë, duke e plotësuar në modulën e aplikimeve *online* për Autorizim të Përgjithshëm sipas pikës 2 të mësipërme.
Nëse personi brenda 15 ditëve kalendarike nga data e njoftimit të AKEP nuk e paraqet *online* informacionin e kërkuar, AKEP-i *online* informon personin se nuk do ta regjistrojë atë. Spërmarrësi ka të drejtë të ankohet në Këshillin Drejtues të AKEP për këtë çështje, duke zbatuar procedurën e parashikuar në Kodin e Procedurave Administrative, kundra njoftimit të AKEP për mos-regjistrimin.
11. Konfirmimi për kryerjen e regjistrimit bëhet nga AKEP nëpërmjet lëshimit të dokumentit “*Certifikatë e Konfirmimit të Njoftimit*” sipas formës dhe përmbajtjes së përcaktuar në këtë rregullore, brenda afatit ligjor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 9918 dhe i dërgohet sipërmarrësit e skanuar në rrugë elektronike.
Njëkohësisht, dokumenti origjinal terhiqet dorazi në zyren e protokollit të AKEP ose i dërgohet sipërmarrësit nga AKEP nëpërmjet shërbimit postar në adresën postare të përcaktuar nga aplikuesi në informacionin e paraqitur në procesin e njoftimit.
12. Nëse AKEP nuk konfirmon me shkrim brenda afatit të përcaktuar në pikën 5 të nenit 14 të ligjit 9918, ose nuk informon sipërmarrësin për plotësimin e informacionin të munguar, sipas pikës 6 të këtij neni, njoftimi vlerësohet i plotë dhe regjistrimi përkatës quhet i kryer.
13. Sipërmarrësit/subjektet e regjistruar në *database*, janë të detyruar të raportojnë në AKEP të gjitha ndryshimet në informacionin e paraqitur gjatë njoftimit fillestar dhe atij pararendës, brenda 30 ditëve nga ndodhja e tyre.
Konsiderohen ndryshime në informacionin e paraqitur edhe ndryshimet që lidhen me:
a) ofrimin e rrjeteve dhe /ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të tjera, përveç atyre të deklaruara në *Njoftimin e Regjistrimit* pararendës;

- b) ndërprerja e një ose disa nga rrjetet dhe/ose shërbimet e komunikimit elektronik të njoftuara më parë në *Njoftimin e Regjistrimit*;
- c) mbyllja e plotë nga sipërmarrësi/subjekti e ofrimit të rrjetit ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të regjistruara dhe të konfirmuara sipas procedurës së njoftimit të përcaktuar në këtë nen.

Raportimi i ndryshimeve nga sipërmarrësi/subjekti dhe regjistrimi i tyre në *database* kryhet sipas të njëjtës procedurë që zbatohet për njoftimin dhe për çdo ndryshim.

Përveç rastit të njoftimit për mbylljen e plotë të ofrimit të rrjetit ose shërbimeve elektronike të regjistruara në *database*, konfirmimi i regjistrimit të ndryshimi/ve të ndodhura kryhet nga AKEP duke amenduar CKNJ e lëshuar për regjistrimin fillestar, sipas ndryshimeve të ndodhura dhe të njoftuara.

- 14. Në rastet e njoftimit të mbylljes së plotë të ofrimit të rrjetit ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të regjistruara në *database*, ose në rastet e zbatimit të një vendimi administrativ sipas parashikimeve ligjore, për revokimin ose shfuqizimin e CKNJ, AKEP kryen ç' regjistrimin nga *database* sipas procedurës së përcaktuar në këtë rregullore.
- 14. E njejta procedurë për njoftimin e ofrimit të rrjetit dhe konfirmimin e regjistrimit të njoftimit dhe të njejtat detyrime (*Formulari i Njoftimit Online - Aneks B/1*), zbatohen edhe nga personat fizikë dhe juridikë të përcaktuar sipas ligjit nr. 97/2013, për të cilët ofrimi i rrjeteve për transmetimet audio dhe/ose audiovizive, kërkon përdorimin e frekuencave që administrohen nga AKEP sipas ligjit nr. 9918, ose që nuk kërkon përdorimin e frekuencave, si:
 - a) rrjetet e transmetimit kabllor;
 - b) rrjetet e transmetimit satelitor.
- 15. Regjistrimi i personave fizikë dhe juridikë që sipas ligjit nr. 97/2013 njoftojnë në AKEP ofrimin e rrjetit për transmetime audio dhe/ose audiovizive, kryhet në "***Modulin e aplikimeve online***" në një *menu (instance)* të veçantë të krijuar dhe administruar nga AKEP për këtë qëllim.

Neni 7

Certifikata e Konfirmimit të Njoftimit

- 1. AKEP konfirmon regjistrimin e njoftimit të sipërmarrësit/subjektit në *database* për ofrimin e rrjetit ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, nëpërmjet Certifikatës së Konfirmimit të Njoftimit (CKNJ).
- 2. CKNJ-Tip që AKEP lëshon për sipërmarrësit/subjektet që ofrojnë rrjet ose shërbime të komunikimeve elektronike sipas rregullave të parashikuara në ligjin nr. 9918 dhe aktet nënligjore dhe rregullatore në zbatim të tij, pasqyrohet në Aneksin C të kësaj rregulloreje.
- 3. CKNJ-Tip që AKEP lëshon për ofrimin e rrjeteve për transmetime audiovizive sipas pikës 2 dhe 3 të nenit 54 të ligjit nr. 97/2013 pasqyrohet në Aneksin C/1 të kësaj rregulloreje.
- 4. CKNJ i dërgohet sipërmarrësit/subjektit nga AKEP me shkrim në rrugë postare (origjinali), elektronike (e skanuar), dhe/ose tërhiqet dorazi, sipas përcaktimit të parashikuar në pikën 11 të nenit 6 të kësaj rregullore.
- 5. CKNJ përbëhet nga faqia e parë e cila përmban:

- a) Stemën e Republikës së Shqipërisë dhe emrin e institucionit që e lëshon, AKEP
- b) Emërtesën: CERTIFIKATË E KONFIRMIMIT TË NJOFTIMIT;

- c) Numrin dhe datën e lëshimit të dokumentit;
- d) Tekstin e konfirmimit të regjistrimit të njoftimit;
- e) Emrin e titullarit, nënshkrimin e tij dhe vulën e institucionit;

si dhe nga faqja/et vijuese që përmbajnë:

- f) Rrjetin dhe/ose shërbimet e njoftuara dhe të regjistruara, që autorizohen të ofrohen;
- g) Kushtet e përgjithshme të vendosura nga AKEP të detyruara për t'u zbatuar sipas llojit të rrjetit ose shërbimeve të komunikimeve elektronike që autorizohen të ofrohen;
- i) Informacionin mbi regjistrimin në *database*;
- j) Elementin Bar Code / QR_Code:



- k) Numrin dhe datën e CKNJ në pjesën e fundit të faqes.

6. Vlefshmeria e regjistrimit të njoftimit të regjistruar në *database* dhe i konfirmuar nga AKEP nëpërmjet CKNJ, është pa afat të caktuar dhe përfundon vetëm me ç' regjistrimin e tij sipas rasteve të përcaktuara në këtë rregullore.
7. CKNJ lëshohet në 2 (dy) ekzemplarë origjinalë, një kopje për sipërmarrësin/subjektin dhe një kopje për AKEP.
8. Në rastet e njoftimit të ndryshimeve të ndodhura në informacionin e dhënë fillestar ose atë pararendës, në CKNJ që AKEP lëshon për konfirmimin e regjistrimit të njoftimit mbi ndryshimin e ndodhur, në faqen e parë të saj, tek teksti për konfirmimin vendos në çdo rast shënimin :
“ Për konfirmimin e regjistrimit të njoftimit datë xx. xx. xxxx (data, muaji, viti) mbi ndryshimin/et e ndodhura në të dhënat e regjistruara sipas CKNJ Nr____, datë xx.xx.xxxx (të CKNJ pararendëse)”, si dhe reflektohen ndryshimi/et e ndodhura të njoftuara.

Neni 8

Regjistri i përditësuar (*database*)

1. Për sipërmarrësit/subjektet, të cilët kanë njoftuar sipas përcaktimeve të nenit 14 të ligjit nr. 9918 dhe kësaj rregullore, AKEP krijon dhe administron një regjistër të përditësuar, bazë të dhënash “*database*” e cila përmban detyrimisht informacionin e përcaktuar në këtë dispozitë ligjore dhe pikën 5 të nenit 5 të rregullores. Baza e të dhënave (*database*) është publikisht e aksesueshme.

2. Forma dhe përmbajtja e regjistrit të përditësuar (*database*) pasqyrohet në Aneksin D të kësaj rregullore dhe në çdo rast përmban, por pa u kufizuar:
 - a) Emrin dhe adresën e sipërmarrësit;
 - b) Të dhënat e regjistrimit ligjor të sipërmarrësit në regjistër sipas ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar:
 - numrin e identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT/NUIS);
 - përfaqësuesin ligjor;
 - ekstraktin historik;
 - c) Personat e kontaktit të sipërmarrësit me AKEP:
 - të dhënat si telefon, faks, email;
 - ç) Përshkrimin e shkurtër të rrjetit ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të njoftuara së bashku me masat e parashikuara për sigurinë e tyre në përputhje me aktet e nxjerra nga AKEP për këtë qëllim;
 - d) Datën kur është parashikuar:
 - fillimi i ofrimit të rrjetit ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të njoftuara;
 - i ndryshimit;
 - mbylljes së veprimtarisë;
 - e) Data e lëshimit të CKNJ nga AKEP.

3. Regjistri i përditësuar (*database*) për personat fizikë dhe juridikë që ofrojnë rrjet të komunikimeve elektronike për qëllime të transmetimit të programeve audio dhe/ose audiovizive sipas ligjit nr. 97/2103, krijohet dhe administrohet nga AKEP në të njëjtën formë dhe përmbajtje por i ndarë si instance e veçantë nga regjistri i përditësuar i sipërmarrësve që ofrojnë rrjet dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike sipas ligjit nr. 9918 sipas Aneks D/1 të kësaj rregullore.

Neni 9

Kushtet e Përgjithshme

1. Në zbatim të nenit 15 të ligjit nr. 9918, AKEP, në autorizimin e përgjithshëm vendos kushte për:
 - a) kontributin financiar për financimin e shërbimit universal;
 - b) bashkëveprimin e shërbimeve dhe interkoneksionin e rrjeteve;
 - c) sigurimin e disponueshmërisë dhe përdorimin e numrave nga plani i numeracionit për përdoruesit fundorë, duke përfshirë kushtet për këtë përdorim;
 - ç) mbrojtjen e mjedisit, planifikimin territorial, aksesin në pronat e patundshme, përfshirë përdorimin e tyre, bashkëvendosjen ose përdorimin e përbashkët të pajisjeve, përfshirë, nëse është e zbatueshme, çfarëdo garancie financiare ose teknike, që mund të jetë e nevojshme për kryerjen e veprimtarisë;
 - d) mbrojtjen e të dhënave vetjake dhe të privatësisë;
 - dh) mbrojtjen e konsumatorit duke përfshirë sigurimin e aksesit për përdoruesit me aftësi të kufizuara;
 - e) respektimin e kufizimeve në lidhje me përmbajtjen e paligjshme ose të dëmshme, sipas rregullimeve përkatëse ligjore në fuqi;
 - ë) informacionin, i cili duhet të paraqitet në procedurën e njoftimit, sipas nenit 14 të ligjit nr. 9918, në procedurën për dhënien e të drejtës së përdorimit të burimeve të fundme (frekuenca dhe numeracion), si dhe informacionin, që duhet të paraqitet në AKEP dhe organet e tjera, sipas nenit 16 të këtij ligji;

- f) lejimin e përgjimit nga autoritetet kompetente, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për përgjimin e telekomunikimeve dhe zbatimin e detyrimeve, që burojnë nga ky legjislacion;
 - g) kushtet për ofrimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike në rastet e gjendjes së emergjencës apo të gjendjes së luftës;
 - gj) mbrojtjen e shtetasve ndaj veprimeve të dëmshme të rrezatimit elektromagnetik, të përhapur nga rrjetet e komunikimeve elektronike;
 - h) detyrimin për të ofruar akses;
 - i) mirëmbajtjen e integritetit të rrjeteve të komunikimeve publike dhe parandalimin e ndërhyrjeve elektromagnetike ndërmjet rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike;
 - j) mbrojtjen e rrjeteve të komunikimeve publike ndaj aksesit të paautorizuar;
 - k) përdorimin e frekuencave duke siguruar përdorimin eficient të spektrit të frekuencave dhe parandalimin e interferencave të dëmshme;
 - l) detyrimin për të plotësuar standardet dhe specifikimet teknike të rrjeteve dhe të pajisjeve për ndërtimin e rrjeteve dhe ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, si dhe të shërbimeve e faciliteteve shoqëruese, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9918;
 - ll) përdorimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimit nga autoritetet publike, për të paralajmëruar publikun për kërcënimet e pashmangshme nga katastrofa të mëdha dhe për zbutjen e pasojave nga katastrofat e mëdha;
 - m) detyrimet e operatorëve të rrjeteve të komunikimeve elektronike që ofrojnë komunikimin ndërmjet pikave fundore të rrjetit për transparencë dhe informim për kufizimet e aksesit ose të përdorimit të shërbimeve, aplikimeve në rastin e zbatimit të tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Aneksi E i kësaj rregullore përmban kushtet e përgjithshme që AKEP ka vendosur sipas pikës 1 të këtij neni, për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike.
 3. AKEP, në përputhje me rrjetin dhe shërbimet e komunikimeve elektronike të njoftuara, dhe të regjistruara në database, përcakton edhe detyrimin e sipërmarrësit/subjektit për zbatimin e plotë ose të pjesshëm të kushteve të përgjithshme sipas Aneksit E të rregullores, duke vendosur informacionin përkatës në CKNJ e lëshuar për konfirmimin e regjistrimit.
 4. Kushtet e përgjithshme të vendosura në autorizimin e përgjithshëm sipas Aneksit E të rregullores janë objekt rishikimi nga AKEP në varësi të ndryshimeve që pëson kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi. Ndryshimi i kushteve të përgjithshme kryhet nëpërmjet zbatimit të një procedure këshillimi publik me palët e interesuara sipas nenit 110 të ligjit nr. 9918.

KREU IV DISPOZITA TË VEÇANTA DHE KALIMTARE

Neni 10 Ç' regjistrimi nga *database*

1. Ç' regjistrimi i sipërmarrësit/subjektit të regjistruar në *database* sipas kësaj rregullore kryhet me:
 - a) kërkesën e vetë sipërmarrësit/subjektit;

b) me nismën e AKEP në zbatim të një vendimi përfundimtar administrativ ose gjykatë, për shkaqe të bazuara në ligjin nr. 9918, aktet nënligjore në zbatim të tij dhe kuadrin rregullator.

2. Vendimi administrativ për ç'regjistrimin e sipërmarrësit/subjektit nga *database*, referuar *germës b) te pikës 2 te këtij neni*, merret nga Këshilli Drejtues i AKEP mbi bazën e shqyrtimit të propozimit të inspektorëve të AKEP sipas nenit 135 të ligjit nr. 9918 dhe veprimeve të kryera sipas Rregullore nr. 46, datë 27. 10. 2016 “Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike” (**Rregullore nr. 46**), duke zbatuar një procedurë administrative sipas Kodit të Procedurave Administrative në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
3. Njëkohësisht me vendimin për ç'regjistrimin e sipërmarrësit/subjektit nga *database*, Këshilli Drejtues merr edhe vendimin për shfuqizimin e CKNJ në fuqi.
4. Vendimi administrativ për ç'regjistrimin e sipërmarrësit/subjektit është i ankimueshëm në rrugë gjyqësore sipas përcaktime të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative dhe ligjin nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” të ndryshuar.
5. Kur ç'regjistrimi nga *database* bëhet me kërkesën e sipërmarrësit/subjektit, përpara kryerjes së ç'regjistrimit, AKEP kryen verifikimin e përmbushjes së të gjitha detyrimeve financiare dhe ligjore të përcaktuara në autorizimin e përgjithshëm duke mbajtur një akt konstatimi në fund të procesit.

Procesi i verifikimit nga AKEP mbi përmbushjen e detyrimeve të sipërmarrësit zgjat jo më shumë se 30 ditë. Akti i konstatimit i njoftohet sipërmarrësit së bashku me kërkesën për shlyerjen e detyrimeve financiare të pa përmbushura në se ka të tilla.

Ç'regjistrimi kryhet nga AKEP pasi sipërmarrësi/subjekti të ketë përmbushur të gjitha detyrimet e mësipërcituara.

Neni 11

Gjobat

1. Moszbatimi nga sipërmarrësit/subjektet i kërkesave ligjore lidhur me detyrimin e njoftimit si dhe të kushteve të përcaktuara në autorizimin e përgjithshëm, kur nuk përbën vepër penale përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas parashikimeve të përcaktuara në nenin 137 të ligjit nr. 9918.
2. Sipërmarrësve/subjekteve, të cilëve nga organet kompetente, sipas ligjit referues u vërtetohet shkelje e ligjshmërisë së përcaktuar në kushtet e përgjithshme të autorizimit të përgjithshëm, janë subjekte të penaliteteve që parashikon ligji referues në secilin rast.

Neni 12

Shfuqizime

Rregullore nr. 24, datë 02. 02. 2012 “Për Autorizimin e Përgjithshëm” e ndryshuar, së bashku me Anekset bashkëlidhur, shfuqizohet.

Neni 13
Hyrja në fuqi

“Rregullorja për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm”, hyn në fuqi më datë 1 janar 2018.

ANEKS A

**LISTA E PËRDITËSUAR E RRJETEVE DHE SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE QË MUND TË NJOFTOHEN PËR T’U OFRUAR NGA
SIPËRMARRËSIT/SUBJEKTET**

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Sipërmarrësi/subjekti i regjistruar nga AKEP sipas njoftimit të bërë prej tij, ka detyrimin ligjor të ofrojë vetëm ato rrjete dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike të regjistruara në database dhe të përcaktuara në Çertifikatën e Konfirmimit të Njoftimit, në përputhje të plotë me kushtet e përgjithshme dhe/ose të veçanta të vendosura nga AKEP.
2. Rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike të cilat mund të ofrohen nga sipërmarrësit përcaktohen në këtë rregullore në “Aneksin A” të saj.
3. Rrjetet ose shërbimet e komunikimeve elektronike të papërcaktuara në këtë rregullore ose akte të veçanta rregullatore të nxjerra nga AKEP, si dhe kushtet e veçanta të ofrimit të tyre, në varësi të kërkesës dhe perspektivës së zhvillimit të tregut, përcaktohen nga AKEP me akte individuale ose të përgjithshme rregullatore dhe bëhen pjesë e Autorizimit të Përgjithshëm.
4. Ofrimi i rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të pa njoftuara paraprakisht në AKEP sipas kësaj Rregullore, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas pikës I.1 të nenit 137 të ligjit nr. 9918.

II. RRJETET E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE QË MUND TË OFROHEN:

1. Rrjete të komunikimeve elektronike që janë sisteme të transmetimit dhe, nëse ekzistojnë, sisteme të komutimit ose rrugëzimit dhe burime të tjera, përfshirë elementet e rrjetit që nuk janë aktive, të cilat lejojnë përcjelljen e sinjaleve nëpërmjet përcjellësve, radios, mjeteve optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike, për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, sipas këtij klasifikimi:
 - a) Rrjet i qëndrueshëm (fiks) i komunikimeve publike;
 - b) Rrjet i lëvizshëm i komunikimeve publike;
 - c) Rrjet satelitor i komunikimeve publike
2. Rrjete të komunikimeve elektronike, për ofrimin e transmetimeve audio dhe/ose audiovizive, sipas këtij klasifikimi:

- a) Rrjet për transmetimet audio dhe/ose audiovizive që kërkon përdorimin e frekuencave që administrohen nga AKEP sipas ligjit nr.9918;
 - b) Rrjet për transmetimet audio dhe/ose audiovizive që nuk kërkon përdorimin e frekuencave:
 - i) rrjet i transmetimit kabllor;
 - ii) rrjet i transmetimit satelitor.
3. Rrjet të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë, i cili është rrjet i komunikimeve elektronike që ka kapacitetin të ofrojë akses në shërbime me brez të gjerë (*broadband*), me shpejtësi, të paktën, 30 Mbps.

III. SHËRBIMET E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE QË MUND TË OFROHEN:

1. Shërbim telefonik i disponueshëm për publikun i cili është një shërbim i disponueshëm për publikun për origjinimin dhe marrjen direkte ose indirekte të thirrjeve kombëtare, apo ndërkombëtare, nëpërmjet një ose më shumë numrave në një plan numeracioni telefonik kombëtar ose ndërkombëtar, sipas këtij klasifikimi:
- a) Shërbim publik telefonik i lëvizshëm tokësor;
 - b) Shërbim publik telefonik i qëndrueshëm (fiks);
 - c) Shërbim publik telefonik nomadik.
 - d) Shërbim publik telefonik satelitor.
2. Shërbim për ofrimin e transmetimit të të dhënave, të disponueshme për publikun.
3. Shërbim për ofrimin e aksesit në Internet, të disponueshëm për publikun.
4. Shërbim për ofrimin e aksesit në shërbime me brez të gjerë (*broadband*) të disponueshme për publikun, me shpejtësi, të paktën, 30 Mbps.
5. Shërbimet e radiokomunikimeve, të disponueshme për publikun.
6. Shërbim me vlerë të shtuar.
7. Ofrim i shërbimeve me shumicë, të:
 - a) Origjinimit të thirrjeve kombëtare dhe ose ndërkombëtare në rrjetin telefonik publik të ofruara nga vendodhje fikse/të lëvizshme;
 - b) Tranzitimit të thirrjeve kombëtare dhe /ose ndërkombëtare në rrjetin telefonik publik të ofruara nga vendodhje fikse/të lëvizshme
 - c) Terminimit të thirrjeve kombëtare dhe/ose ndërkombëtare për rrjete publike telefonike individuale të ofruara nga vendodhje fikse/të lëvizshme.
8. Shërbim për dhënien e linjave me qira për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun.
9. Për ofrimin e shërbimit universal.

**ANEKS B****FORMULARI I NJOFTIMIT ONLINE PËR REGJISTRIMIN E
OFRIMIT TË RRJETEVE DHE SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE**

Datë:

N.º Aplikimit:

 Fillimi Shërbimit/Rrjetit Mbyllje të aktivitetit

Ndryshim

 Shtim shërbimi Heqje shërbimi Ndryshim të të dhënave**I. Të dhëna të nevojshme për identifikimin dhe komunikimin.**

Emri i subjekti:

Adresa Vendbanimi/Zyra qendrore e subjektit:

Qyteti / Shteti

Telefon

Fax

E-mail

Website

Subjekti është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) në:

Qarku/Rrethi/Qyteti:

Si: (SH.P.K./SH.A. etj.)

NIPT-i

Emri i Përfaqësuesit ligjor të subjektit:

Numri personal i letërnjoftimit/kartës
së identitetit-ID

Adresa

Kutia Postare

Qyteti

Qarku/Rrethi

Telefon

Fax

E-mail



Personi i Kontaktit (<i>Drejtuesi Teknik</i>)		
Telefon	Fax	E-mail

II. DOSJA E PËRSHKRIMIT PËR RRJETET DHE SHËRBIMET

Përshkrimi i llojeve të rrjetit ose shërbimeve që aplikuesi do të ofrojë, si dhe koha e fillimit të aktivitetit:

1. Rrjete publike të komunikimeve elektronike: Datë: |.|.|.|.|
2. Shërbime publike të komunikimeve elektronike:
- a) Shërbime telefonike: Datë: |.|.|.|.|
- b) Shërbimi i aksesit në internet: Datë: |.|.|.|.|
- c) Shërbimi transmetimit të të dhënave Datë: |.|.|.|.|
- d) Shërbime të tjera: Datë: |.|.|.|.|

Subjekti kërkon që t'i lëshohet certifikata e konfirmimit të njoftimit e ofruesit të rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike:

- Po

Subjekti bashkëngjit dokumentet e mëposhtëm, të cilat janë pjesë e njoftimit:

- a) kopje të ekstraktit të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe kopje të ekstraktit historik;
- b) kopje të statutit, bashkë me ndryshimet dhe plotësimet e pësuara, dhe kopje të dokumenteve që provojnë cilësinë e përfaqësuesit ligjor të personit të përmendur në njoftim;
- c) kopje të letërnjoftimit (kartës së identitetit) ID të personit (juridik/fizik), nëse ai është person fizik;
- d) përshkrimi teknik për rrjetet dhe/ose shërbimet që kërkon të ofrojë dhe masat e marra për mbrojtjen dhe sigurinë e tyre;
- e) të dhëna për sistemin e billingut;
- f) kontratën tip të pajtimit (termat dhe kushtet e përgjithshme);
- g) një marrëveshje interkoneksioni / aksesit paraprake (nëse aplikohet për shërbimin/rrjetin e ofruar);
- h) formulari i aplikimit për caktimin e Kodit NSPC (Sipas kërkesave të pikës C1 të këtij formulari);
- i) formulari i aplikimit për caktimin e Kodit ISPC. (Sipas kërkesave të pikës C1 të këtij formulari);
- j) të dhëna për sigurinë e rrjeteve dhe shërbimeve
- k) të tjera.

Subjekti është dakord që adresa dhe kontaktet e tij të publikohet në Regjistrin e Ofruesve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike

**A. RRJETE PUBLIKE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE****1. Rrjete publike tokësore fikse**

Rrjet i qëndrueshëm (fiks) i komunikimeve publike

1.1. Zona e ofritit	<input type="checkbox"/> Bashkitë, <input type="checkbox"/> Njësi Administrative, <input type="checkbox"/> Rrugë nacionale, <input type="checkbox"/> Rruge dytësore, <input type="checkbox"/> Të tjera (specifikoj) _____
1.2. Rrjeti i aksesit	<input type="checkbox"/> Përcjellësa metalike <input type="checkbox"/> i veti <input type="checkbox"/> marrë me qira (nga)
	<input type="checkbox"/> Kabëll koaksial <input type="checkbox"/> i veti <input type="checkbox"/> marrë me qira (nga)
	<input type="checkbox"/> Fibër optike <input type="checkbox"/> i veti <input type="checkbox"/> marrë me qira (nga)
	<input type="checkbox"/> Radio <input type="checkbox"/> i veti <input type="checkbox"/> marrë me qira (nga)
1.3. Rrjeti i transmetimit	<input type="checkbox"/> Përcjellësa metalikë <input type="checkbox"/> i veti <input type="checkbox"/> marrë me qira (nga)
	<input type="checkbox"/> Kabëll Koaksial <input type="checkbox"/> i veti <input type="checkbox"/> marrë me qira (nga)
	<input type="checkbox"/> Fibër optike <input type="checkbox"/> i veti <input type="checkbox"/> marrë me qira (nga)
	<input type="checkbox"/> Radio <input type="checkbox"/> i veti <input type="checkbox"/> marrë me qira (nga)
1.4. Llojet e shërbimeve	<input type="checkbox"/> Telefoni fikse <input type="checkbox"/> Akses Interneti <input type="checkbox"/> Transmetim të dhënash, <input type="checkbox"/> Linja me qera, <input type="checkbox"/> Shërbime të tjera (specifikoj).

1.5. Brezi i frekuencave në të cilin operojnë radio segmentet e rrjetit:

Rrjeti i aksesit:.....

Rrjeti i transportit:.....

1.6. Faza e ofritit:

Rrjet jo funksionues (në ndërtim). Koha e parashikuar për përfundim të ndërtimit (**data/muaji/viti**)

Rrjet funksionues. Koha e vënies në funksionim (**data/muaji/viti**)



2. Rrjete publike tokësore të lëvizshëm

<input type="checkbox"/> Rrjet i lëvizshëm i komunikimeve publike	2.1 Llojet	<input type="checkbox"/> GSM <input type="checkbox"/> UMTS <input type="checkbox"/> IMT (fiks/i lëvizshëm) <input type="checkbox"/> WiMAX <input type="checkbox"/> LTE <input type="checkbox"/> Të tjera (specifikoji)	
	2.2 Zona e ofrimit	<input type="checkbox"/> Kombëtare, <input type="checkbox"/> Bashkitë, <input type="checkbox"/> Njësia Administrative, <input type="checkbox"/> Rrugë nacionale, <input type="checkbox"/> Rrugë dytësore, <input type="checkbox"/> Të tjera (specifikoji) _____	
	2.3 Rrjeti i Transmetimit	<input type="checkbox"/> Përcjellësa metalike	<input type="checkbox"/> i veti <input type="checkbox"/> marrë me qira (nga)
		<input type="checkbox"/> Kabëll Koaksial	<input type="checkbox"/> i veti <input type="checkbox"/> marrë me qira (nga)
		<input type="checkbox"/> Fibër Optike	<input type="checkbox"/> i veti <input type="checkbox"/> marrë me qira (nga)
<input type="checkbox"/> Radio		<input type="checkbox"/> i veti <input type="checkbox"/> marrë me qira (nga)	
2.4 Llojet e shërbimeve ofrimi i të cilave është i lejuar nga mënyra e ndërtimit të rrjetit	<input type="checkbox"/> Telefoni, <input type="checkbox"/> Transmetim të dhënash, <input type="checkbox"/> Akses Interneti, <input type="checkbox"/> Shërbime të tjera (specifikoji).		
2.5 Brezi i frekuencave në të cilin operon rrjeti i transmetimit radio në (MHz ose GHz):			
2.6 Faza e ofrimit: <input type="checkbox"/> Rrjet jo funksionues (në ndërtim). Koha e parashikuar për përfundim të ndërtimit (data/muaji/viti) <input type="checkbox"/> Rrjet funksionues Koha e vënies në funksionim (data/muaji/viti)			

3. Rrjet satelitor i komunikimeve publike

<input type="checkbox"/> Rrjete satelitore	3.1 Brezi i frekuencave në të cilin ai operon:	<input type="checkbox"/> Downlink (descending link) Frekuenca e punës
		<input type="checkbox"/> Uplink (ascending link) Frekuenca e punës
3.2. Operatori i segmentit hapësinor:		
3.3 Llojet e shërbimeve ofrimi i të cilave është i lejuar nga mënyra e ndërtimit të rrjetit.	<input type="checkbox"/> Telefoni	
	<input type="checkbox"/> Dhënia me qira e segmentit hapësinor	<input type="checkbox"/> përdoruesve <input type="checkbox"/> përdoruesve fundore <input type="checkbox"/> përdoruesve të tjerë të segmentit hapësinor
3.4. Stacion koordinues në Shqipëri:	<input type="checkbox"/> Transmetim të dhënash, <input type="checkbox"/> Akses interneti, <input type="checkbox"/> Shërbime të tjera (specifikoji).	
	<input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> Po. Vendndodhja: Koordinatat gjeografike	
3.5. Rrjeti është i lidhur me rrjetin publik të komunikimeve elektronike	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo	
3. 6 Faza e ofrimit: <input type="checkbox"/> Rrjet jo funksionues (në ndërtim). Koha e parashikuar për përfundim të ndërtimit (data/muaji/viti) <input type="checkbox"/> Rrjet funksionues. Koha e vënies në funksionim (data/muaji/viti)		

**B. SHËRBIME PUBLIKE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE****1. Shërbim publik telefonik**

1.1 <input type="checkbox"/> Shërbim publik telefonik i qëndrueshëm (fiks)	1.1.1. Karakteristika të shërbimit	<input type="checkbox"/> Telefona publike me pagesë <input type="checkbox"/> Akses në rrjetin publik telefonik	<input type="checkbox"/> Thirrje lokale <input type="checkbox"/> Thirrje kombëtare <input type="checkbox"/> Thirrje ndërkombëtare	<input type="checkbox"/> Interkoneksioni kombëtar <input type="checkbox"/> Të dhëna të Pikës Kombëtare të Sinjalizimit (NSPC) <input type="checkbox"/> Kodi NSPC (.....) <input type="checkbox"/> Interkoneksioni ndërkombëtar (ne se ka) <input type="checkbox"/> Të dhëna të Pikës Ndërkombëtare të Sinjalizimit <input type="checkbox"/> Kodi ISPC (ne se ka) <input type="checkbox"/> Kodi i pikës së Sinjalizimit në distancë (ne se ka) <input type="checkbox"/> Të tjera (.....)
	1.1.2. Shërbime të tjera	<input type="checkbox"/> Faks <input type="checkbox"/> Posta zanore <input type="checkbox"/> Kujdesi për klientin	<input type="checkbox"/> Numërori telefonik <input type="checkbox"/> Shërbime të tjera (specifikoji)	
	1.1.3. Rrjete me anë të të cilave ofrohet shërbimi (zona e ofrimit të shërbimit)	<input type="checkbox"/> Rrjete të veta: <input type="checkbox"/> Rrjete të cilat janë pronë e të tretëve të autorizuar		
	1.1.4. Faza e ofrimit të shërbimit:	<input type="checkbox"/> Shërbim jo funksionues. Koha e parashikuar për fillimin e ofrimit (data/muaji/viti) <input type="checkbox"/> Shërbim funksionues. Koha e vënies në funksionim (data/muaji/viti)		

**1.2. Shërbim publik
telefonik i lëvizshëm
tokësor**1.2.1. Llojet e
shërbimeve të
ofruara Thirrje lokale Thirrje kombëtare Thirrje ndërkombëtare Interkoneksion kombëtar Të dhëna të Pikës
Kombëtare
të Sinjalizimit (NSPC) Kodi NSPC (.....) Interkoneksion ndërkombëtar
(ne se ka) Të dhëna të Pikës
Ndërkombëtare
të Sinjalizimit Kodi ISPC (ne se ka) Kodi i pikës së
Sinjalizimit në distancë
(ne se ka) Të tjera (.....)1.2.2. Shërbime të
tjera
(specifikoji) Faks
 Posta zanore
 Kujdesi për klientin Numërori telefonik
 Shërbime të tjera

1.2.3. . Rrjete me anë të të cilave ofrohet shërbimi (zona e ofrimit të shërbimit)

 Rrjete të veta: Rrjete të cilat janë prone e të tretëve të autorizuar

1.2.4. Faza e ofrimit të shërbimit:

 Shërbim jo funksionues. Koha e parashikuar për fillimin e ofrimit Shërbim funksionues

**1.3. Shërbim publik telefonik satelitor**

1.3.1. Llojet e shërbimeve të ofruara

1.3.2.1. Rrjete fikse Rrjete të veta: Rrjete të cilat janë pronë e të tretëve të autorizuar1.3.2.2. Rrjete të lëvizshëm Rrjete të veta:..... Rrjete të cilat janë pronë e të tretëve të autorizuar.....1.3.2.3. Informacion mbi frekuencat Rrjeti aksesit Rrjeti transportit

1.3.2. Rrjete me anë të të cilave ofrohet shërbimi

1.3.3. Faza e ofrimit:

 Shërbim jo funksionues. Koha e parashikuar për fillimin e ofrimit (**data/muaji/viti**) Shërbim funksionues. Koha e vënies në funksionim (**data/muaji/viti**)



1.4. <input type="checkbox"/> Shërbimeve me shumicë			1.4.(1,2,3).1 <input type="checkbox"/> Mënyra e aksesit <input type="checkbox"/> Teknologjitë e transportimit	<input type="checkbox"/> Direkt (midis ofruesve të rrjetit) <input type="checkbox"/> Zgjedhja <input type="checkbox"/> Parazgjedhja <input type="checkbox"/> fiks-fiks <input type="checkbox"/> fiks-mobile <input type="checkbox"/> mobile-mobile <input type="checkbox"/> ISP-ISP
	1.4.1 <input type="checkbox"/> Origjinim Thirrjesh	<input type="checkbox"/> Kombëtar <input type="checkbox"/> Ndërkombëtar	1.4.(1,2,3).2 <input type="checkbox"/> Të dhënat e pikës së Interkoneksionit	1.4.(1,2,3).2.1 <input type="checkbox"/> PSTN 1.4.(1,2,3).2.2 <input type="checkbox"/> Interkoneksion Internet <input type="checkbox"/> Peering <input type="checkbox"/> Tranzit <input type="checkbox"/> Interkoneksion Ndërkombëtar VoIP 1.4.(1,2,3).3.1 <input type="checkbox"/> Akses direkt <input type="checkbox"/> Fiber Optike (kapaciteti për t'u plotësuar)... <input type="checkbox"/> Satelitor (kapaciteti për t'u plotësuar)... <input type="checkbox"/> Linja me qira (kapaciteti për t'u plotësuar) <input type="checkbox"/> Lidhje fikse radio (kapaciteti për t'u plotë) <input type="checkbox"/> Të tjera (specifikoj)
	1.4.2 <input type="checkbox"/> Tranzitim Thirrjesh	<input type="checkbox"/> Kombëtar <input type="checkbox"/> Ndërkombëtar	1.4.(1,2,3).3 <input type="checkbox"/> Mënyrat e lidhjes ndërkombëtare	1.4.(1,2,3).3.2 <input type="checkbox"/> Akses indirekt (shpjego mënyrën).....
	1.4.3 <input type="checkbox"/> Terminim Thirrjesh	<input type="checkbox"/> Kombëtar <input type="checkbox"/> Ndërkombëtar	1.4.(1,2,3).4 <input type="checkbox"/> Të dhëna mbi Sinjalizimin	1.4.(1,2,3).4.1 <input type="checkbox"/> Të dhëna mbi Tipin e sinjalizimit <input type="checkbox"/> SS7 <input type="checkbox"/> SIP <input type="checkbox"/> H323 etj) <input type="checkbox"/> Të tjera.....
			1.4.(1,2,3).5 <input type="checkbox"/> Marrëveshje paraprake interkoneksioni /aksesi	1.4.(1,2,3).4.2 <input type="checkbox"/> Të dhëna të Pikës Kombëtare të Sinjalizimit (NSPC) <input type="checkbox"/> Kodi NSPC (.....) 1.4.(1,2,3).4.3 <input type="checkbox"/> Të dhëna të Pikës Ndërkombëtare të Sinjalizimit (ISPC) <input type="checkbox"/> Kodi ISPC (.....) 1.4.(1,2,3).4.4 <input type="checkbox"/> Kodi i pikës së sinjalizimit në distancë (.....) 1.4.(1,2,3).5.1 <input type="checkbox"/> Identifiko marrëveshjen me operator in/et..... <input type="checkbox"/> Të tjera.....



1.5. <input type="checkbox"/> Shërbim publik telefonik nomadik	1.5.1. Llojet e Intekoneksionit, Protokolli	
	1.5.2. Rrjete me anë të të cilave ofrohet shërbimi	1.5.2.1. <input type="checkbox"/> Rrjete fikse <input type="checkbox"/> Rrjete të veta: <input type="checkbox"/> Rrjete të cilat janë pronë e të tretëve të autorizuar
	1.5.3. Faza e ofrimit: <input type="checkbox"/> Shërbim jo funksionues. Koha e parashikuar për fillimin e ofrimit (data/muaji/viti) <input type="checkbox"/> Shërbim funksionues. Koha e vënies në funksionim (data/muaji/viti)	1.5.2.2. <input type="checkbox"/> Rrjete të lëvizshëm <input type="checkbox"/> Rrjete të veta:..... <input type="checkbox"/> Rrjete të cilat janë pronë e të tretëve të autorizuar.....
	1.5.4. Protokollet (Specifikoji).....	

2. Shërbimet me vlerë të shtuar

<input type="checkbox"/> Shërbimet me vlerë të shtuar	2.1 <input type="checkbox"/> Tipi i shërbimit	<input type="checkbox"/> Telefoni <input type="checkbox"/> Data <input type="checkbox"/> mesazh zanor/jo zanor <input type="checkbox"/> të tjera.....
	2.2 <input type="checkbox"/> Protokolli	<input type="checkbox"/> peer-to-peer protocol <input type="checkbox"/> service center <input type="checkbox"/> te tjera
	2.3 <input type="checkbox"/> Tipi i rrjetit ku ofrohet shërbimi	<input type="checkbox"/> Fiks <input type="checkbox"/> I lëvizshëm <input type="checkbox"/> Të tjera
2.4 Faza e ofrimit:		
<input type="checkbox"/> Shërbim jo funksionues. Koha e parashikuar për fillimin e ofrimit (data/muaji/viti)		
<input type="checkbox"/> Shërbim funksionues. Koha e vënies në funksionim (data/muaji/viti)		



3. Shërbimet për dhënien e linjave me qira

Llojet e linjave me qira

3.1 Analog Cilësi normale Cilësi speciale3.2 Dixhital deri 2 Mbps mbi 2 Mbps Lloje të tjera (specifikoji)

3.3 Rrjete me anë të të cilave ofrohet shërbimi (zona e ofrimit të shërbimit)

 Rrjete të veta: Rrjete të cilat janë pronë e të tretëve të autorizuar

3.4 Faza e ofrimit:

 Shërbim jo funksionues. Koha e parashikuar për fillimin e ofrimit (**data/muaji/viti**) Shërbim funksionues. Koha e vënies në funksionim (**data/muaji/viti**)

4. Shërbime e transmetimit të të dhënave dhe aksesit ne internet

4.1. Shërbimet e transmetimit të të dhënave të disponueshme për publikun

4.1.1. Llojet e aksesit

 Në vendndodhje fikse Të lëvizshëm

4.1.2. Llojet e shërbimeve:

 Telefoni SMS MMS Te tjera..... Band Allotment: Fikse Broadband Me kërkesë (>Mbps) Minimumi i garantuar Të tjera (specifikoji)

4.1.3. Protokollet dhe teknologjitë e përdorura:

 SDH/PDH ISDN TCP/IP ATM Frame relay X.25 HSCSD GPRS EDGE (IMT, UMTS/LTE/WiMAX) xDSL Cable modem VPN Ethernet Powerline MPLS-TP Të tjera (specifikoji)

4.1.4. Rrjete me anë të të cilave ofrohet shërbimi (zona e ofrimit të shërbimit)

 Rrjete të veta: Rrjete të cilat janë pronë e të tretëve të autorizuar.....

4.1.5. Faza e ofrimit:

 Shërbim jo funksionues. Koha e parashikuar për fillimin e ofrimit (**data/muaji/viti**) Shërbim funksionues. Koha e vënies në funksionim (**data/muaji/viti**)



4.2. <input type="checkbox"/> Ofrimi i shërbimit të aksesit në Internet për publikun		
4.2.1. Mënyrat e lidhjes me përdoruesin fundor		<input type="checkbox"/> Linjë e dedikuar <input type="checkbox"/> Kabëll Koaksial <input type="checkbox"/> Përcjellësa metalike <input type="checkbox"/> Radio <input type="checkbox"/> Fibër optike <input type="checkbox"/> Satelit <input type="checkbox"/> Të tjera (specifikoji)
4.2.2. Llojet e furnizimit të aksesit me brez të gjerë <input type="checkbox"/> Broadband (>30 Mbps)		<input type="checkbox"/> Linjë e dedikuar <input type="checkbox"/> Kabëll Koaksial <input type="checkbox"/> Përcjellësa metalike <input type="checkbox"/> Radio <input type="checkbox"/> Fibër optike <input type="checkbox"/> Satelite <input type="checkbox"/> Të tjera (specifikoji)
4.2.3. Mënyrat e lidhjes ndërkombëtare	4.2.3.1. <input type="checkbox"/> Akses direkt	<input type="checkbox"/> Fibër Optike (kapaciteti për t'u plotësuar)..... <input type="checkbox"/> Satelitor (kapaciteti për t'u plotësuar)..... <input type="checkbox"/> Linja me qira (kapaciteti për t'u plotësuar)..... <input type="checkbox"/> Lidhje fikse radio (kapaciteti për t'u plotësuar)..... <input type="checkbox"/> Të tjera (specifikoji)
	4.2.3.2. <input type="checkbox"/> Akses indirekt (shpjego mënyrën)	
4.2.4. Faza e ofrimit: <input type="checkbox"/> Shërbim jo funksionues. Koha e parashikuar për fillimin e ofrimit (data/muaji/viti) <input type="checkbox"/> Shërbim funksionues. Koha e vënies në funksionim (data/muaji/viti)		

**5. Ofruesi i Shërbimit Universal**

5.1 Infrastruktura e rrjetit		<input type="checkbox"/> Linjë Fikse <input type="checkbox"/> Radio <input type="checkbox"/> Fibër optike <input type="checkbox"/> Të tjera (specifikoji)
5.2 Aksesi		<input type="checkbox"/> Linjë Fikse <input type="checkbox"/> Wireless fikse <input type="checkbox"/> Të tjera (specifikoji)
5.3 Minimumi i kapacitetit të aksesit në Internet <input type="checkbox"/> Broadband (>Mbps)		<input type="checkbox"/> Linjë e dedikuar <input type="checkbox"/> Kabëll Koaksial <input type="checkbox"/> Përcjellësa metalike <input type="checkbox"/> Radio <input type="checkbox"/> Fibër optike <input type="checkbox"/> Satellite <input type="checkbox"/> Të tjera (specifikoji)
5.4 Shërbimet	5.4.1 <input type="checkbox"/> Telefoni 5.4.2 <input type="checkbox"/> Internet 5.4.3 <input type="checkbox"/> Data	
5.5 <input type="checkbox"/> Infrastruktura alternative (shpjego mënyrën).....	5.5.1. Informacion mbi interkoneksionin me rrjetet tjera (Specifikoji).....	
5.6 Identifikoni zonat ofrimit të shërbimit		
5.7 Faza e ofrimit: <input type="checkbox"/> Shërbim jo funksionues. Koha e parashikuar për fillimin e ofrimit (data/muaji/viti) <input type="checkbox"/> Shërbim funksionues. Koha e vënies në funksionim (data/muaji/viti)		

6. Shërbimet e radiokomunikimeve, të disponueshme për publikun

6.1 <input type="checkbox"/> Lloji i rrjetit të radiokomunikimit			<input type="checkbox"/> Fiks	<input type="checkbox"/> I lëvizshëm
6.2. Brezi i frekuencave në të cilin operon rrjeti			<input type="checkbox"/> I transportit	<input type="checkbox"/> I aksesit
6.3. Llojet e shërbimeve ofrimi i të cilave është i lejuar nga mënyra e ndërtimit të rrjetit.		<input type="checkbox"/> Telefoni <input type="checkbox"/> Transmetim të dhënash		
6.4. Rrjeti është i lidhur me rrjetin publik të komunikimeve elektronike		<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo		
6.5. Faza e ofrimit: <input type="checkbox"/> Rrjet jo funksionues (në ndërtim). Koha e parashikuar për përfundim të ndërtimit (data/muaji/viti) <input type="checkbox"/> Rrjet funksionues. Koha e vënies në funksionim (data/muaji/viti)				

**7. Ofrimin e aksesit në shërbime me brez të gjerë për publikun**

7.1 Mënyrat e lidhjes me përdoruesin fundor		<input type="checkbox"/> Linjë e dedikuar <input type="checkbox"/> Kabëll Koaksial <input type="checkbox"/> Përcjellësa metalike <input type="checkbox"/> Radio <input type="checkbox"/> Fibër optike <input type="checkbox"/> Satelit <input type="checkbox"/> Të tjera (specifikoji)
7.2. Llojet e furnizimit të aksesit me brez të gjerë Broadband (>30 Mbps)		<input type="checkbox"/> Linjë e dedikuar <input type="checkbox"/> Kabëll Koaksial <input type="checkbox"/> Përcjellësa metalike <input type="checkbox"/> Radio <input type="checkbox"/> Fibër optike <input type="checkbox"/> Satelite <input type="checkbox"/> Të tjera (specifikoji)
7.3. Llojet e shërbimeve të ofruara me brez të gjerë Broadband (>30 Mbps)		
7.4. Mënyrat e lidhjes ndërkombëtare	7.4.1 <input type="checkbox"/> Akses direkt	<input type="checkbox"/> Fibër Optike (kapaciteti për t'u plotësuar)..... <input type="checkbox"/> Satelitor (kapaciteti për t'u plotësuar)..... <input type="checkbox"/> Linja me qira (kapaciteti për t'u plotësuar)..... <input type="checkbox"/> Lidhje fikse radio (kapaciteti për t'u plotësuar)..... <input type="checkbox"/> Të tjera (specifikoji)
	7.4.2 <input type="checkbox"/> Akses indirekt (shpjego mënyrën)	
7.5 Faza e ofrimit: <input type="checkbox"/> Shërbim jo funksionues. Koha e parashikuar për fillimin e ofrimit (data/muaji/viti) <input type="checkbox"/> Shërbim funksionues. Koha e vënies në funksionim (data/muaji/viti)		

8. Lloje të tjera të shërbimeve

Për t'u plotësuar me të dhënat përkatëse, sipas rastit:

**PARAQITJA E DETYRIMEVE LIGJORE**

- Unë nëpërmjet kësaj deklaroj se do të ushtroj aktivitet në fushën e komunikimeve elektronike të shënuara me sipër dhe të aplikoj për regjistrim në regjistrin e ofrueseve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike (sipërmarrësve) të AKEP.
- Unë nëpërmjet këtij dokumenti deklaroj se kam mbyllur aktivitetet e komunikimeve elektronike të shënuara më sipër.
- Unë nëpërmjet këtij dokumenti deklaroj se kam mbyllur çdo aktivitet të komunikimeve elektronike nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm dhe marr përsipër të shlyej të gjitha detyrimet financiare ndaj AKEP.
- Unë nëpërmjet këtij dokumenti deklaroj se të dhënat e mia kanë pësuar ndryshime, sikurse përshkruhen në formular.
- Unë nëpërmjet këtij dokumenti deklaroj se kam ndryshuar formën ligjore të kompanisë sime siç përshkruhet në formular. Emri i vjetër është si më poshtë:

Unë nëpërmjet këtij dokumenti paraqes në AKEP të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor dhe/ose të gjithë dokumentet që sigurojnë se nënshkruesi i këtij Njoftimi Regjistrimi ka lidhje me personin përfaqësues.

Unë deklaroj se informacioni që përfshihet në deklarinimin e paraqitur, sikurse çdo informacion tjetër shoqërues, është i saktë dhe i vërtetë, dhe jam plotësisht i vetëdijshëm për faktin që, lidhur me angazhimin në çdo aktivitet të komunikimeve elektronike për të cilin është e nevojshme të sigurosh të drejtën e përdorimit për numeracion dhe frekuenca, të drejta të cilat nuk sigurohen nëpërmjet kësaj procedurë, unë duhet të paraqes një aplikim për të fituar të drejtat e përdorimit të cituara më sipër përpara fillimit të ofrimit të shërbimit.

Data e Aplikimit:

/ /

Nënshkrimi dhe Vula**Vendi:**



ANEKS B1

FORMULARI I NJOFTIMIT ONLINE PËR REGJISTRIMIN E OFRIMIT TË RRJETEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE PËR TRANSMETIMET AUDIO DHE/OSE AUDIOVIZIVE

Datë: N.° Aplikimit:	<input type="checkbox"/> Fillimi Shërbimit/Rrjetit <input type="checkbox"/> Mbyllje të aktivitetit	Ndryshim <input type="checkbox"/> Shtim shërbimi <input type="checkbox"/> Heqje shërbimi <input type="checkbox"/> Ndryshim të të dhënave
---	---	--

I. Të dhëna të nevojshme për identifikimin dhe komunikimin.

Emri i subjektit:			
Adresa Vendbanimi/Zyra qendrore e subjektit):			
Qyteti / Shteti			
Telefon	Fax	E-mail	Website
Subjekti është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) në:			
Qarku/Rrethi/Qyteti:		Si:(SH.P.K./SH.A. etj.)	
NIPT-i			



Emri i Përfaqësuesit ligjor të subjektit:		Numri personal i letërnjoftimit/kartës së identitetit-ID
Adresa		Kutia Postare
Qyteti		Qarku/Rrethi
Telefon	Fax	E-mail
Personi i Kontaktit (<i>Drejtuesi Teknik</i>)		
Telefon	Fax	E-mail

II. DOSJA E PËRSHKRIMIT PËR RRJETET

Përshkrimi i llojeve të rrjetit që subjekti do të ofrojë, si dhe koha e fillimit të aktivitetit:

1. Rrjete të komunikimeve elektronike: Datë: |_|_|_|_|_|_|_|

Subjekti kërkon që t'i lëshohet çertifikata e konfirmimit të njoftimit e ofruesit të rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike:

Po

Personi (juridik/fizik) bashkëngjit dokumentat e mëposhtem, të cilat janë pjesë e njoftimit:

- a) kopje të ekstraktit të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe kopje të ekstraktit historik;
- b) kopje të statutit, bashkë me ndryshimet dhe plotësimet e pësuara, dhe kopje të dokumentave që provojnë cilësinë e përfaqësuesit ligjor të personit të përmendur në njoftim;
- c) kopje të letërnjoftimit (kartës së identitetit) ID të personit (juridik/fizik), nëse ai është person fizik;
- d) përshkrimi teknik për rrjetet dhe/ose shërbimet që kërkon të ofrojë dhe masat e marra për mbrojtjen dhe sigurinë e tyre;
- e) të dhëna për sigurinë e rrjeteve dhe shërbimeve
- f) të tjera.

Subjekti është dakord që adresa dhe kontaktet e tij të publikohet në Regjistrin e Ofruesve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike



RRJETE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE PËR OFRIMIN E TRANSMETIMEVE AUDIO DHE/OSE AUDIOVIZIVE

1. Rrjet i transmetimit kabllor

<input type="checkbox"/> Rrjete kabllore	1.1. Zona e ofrimit	<input type="checkbox"/> Bashkitë, <input type="checkbox"/> Njësi Administrative, <input type="checkbox"/> Rrugë nacionale, <input type="checkbox"/> Rruge dytësore, <input type="checkbox"/> Të tjera (specifikoji) _____	
	1.2. Rrjeti i aksesit	<input type="checkbox"/> Përcjellësa metalike	<input type="checkbox"/> i veti <input type="checkbox"/> marrë me qira (nga)
		<input type="checkbox"/> Kabëll koaksial	<input type="checkbox"/> i veti <input type="checkbox"/> marrë me qira (nga)
		<input type="checkbox"/> Fiber optike	<input type="checkbox"/> i veti <input type="checkbox"/> marrë me qira (nga)
		<input type="checkbox"/> Radio	<input type="checkbox"/> i veti <input type="checkbox"/> marrë me qira (nga)
	1.3. Rrjeti i transmetimit	<input type="checkbox"/> Përcjellësa metalikë	<input type="checkbox"/> i veti <input type="checkbox"/> marrë me qira (nga)
		<input type="checkbox"/> Kabëll Koaksial	<input type="checkbox"/> i veti <input type="checkbox"/> marrë me qira (nga)
		<input type="checkbox"/> Fibër optike	<input type="checkbox"/> i veti <input type="checkbox"/> marrë me qira (nga)
		<input type="checkbox"/> Radio	<input type="checkbox"/> i veti <input type="checkbox"/> marrë me qira (nga)

1.4. Faza e ofrimit:

- Rrjet jo funksionues (në ndërtim). Koha e parashikuar për përfundim të ndërtimit (**data/muaji/viti**)
 Rrjet funksionues. Koha e vënies në funksionim (**data/muaji/viti**)

2. Rrjet i transmetimit satelitor

<input type="checkbox"/> Rrjete satelitore	2.1. Brezi i frekuencave në të cilin funksionon	<input type="checkbox"/> Downlink (descending link) Frekuenca e punës
		<input type="checkbox"/> Uplink (ascending link) Frekuenca e punës
2.2 Operatori i segmentit hapësinor:		
2.4 Stacion koordinues në Shqipëri:	<input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> Po. Vendndodhja..... Kordinatat gjeografike	
2.5 Faza e ofrimit: <input type="checkbox"/> Rrjet jo funksionues (në ndërtim). Koha e parashikuar për përfundim të ndërtimit (data/muaji/viti) <input type="checkbox"/> Rrjet funksionues. Koha e vënies në funksionim (data/muaji/viti)		



3. Rrjet qe kërkon përdorimin e frekuencave

Rrjet qe kërkon përdorimin e frekuencave

3.1. Zona e ofrimit	<input type="checkbox"/> Bashkitë, <input type="checkbox"/> Njësi Administrative, <input type="checkbox"/> Rrugë nacionale, <input type="checkbox"/> Rruge dytësore, <input type="checkbox"/> Të tjera (specifikoj) _____
3.2. Rrjeti i aksesit	<input type="checkbox"/> Përcjellësa metalike <input type="checkbox"/> i veti <input type="checkbox"/> marrë me qira (nga)
	<input type="checkbox"/> Kabëll koaksial <input type="checkbox"/> i veti <input type="checkbox"/> marrë me qira (nga)
	<input type="checkbox"/> Fiber optike <input type="checkbox"/> i veti <input type="checkbox"/> marrë me qira (nga)
	<input type="checkbox"/> Radio <input type="checkbox"/> i veti <input type="checkbox"/> marrë me qira (nga)
3.3. Rrjeti i transmetimit	<input type="checkbox"/> Përcjellësa metalikë <input type="checkbox"/> i veti <input type="checkbox"/> marrë me qira (nga)
	<input type="checkbox"/> Kabëll Koaksial <input type="checkbox"/> i veti <input type="checkbox"/> marrë me qira (nga)
	<input type="checkbox"/> Fibër optike <input type="checkbox"/> i veti <input type="checkbox"/> marrë me qira (nga)
	<input type="checkbox"/> Radio <input type="checkbox"/> i veti <input type="checkbox"/> marrë me qira (nga)

3.4. Faza e ofrimit:

- Rrjet jo funksionues (në ndërtim). Koha e parashikuar për përfundim të ndërtimit (**data/muaji/viti**)
- Rrjet funksionues. Koha e vënies në funksionim (**data/muaji/viti**)



PARAQITJA E DETYRIMEVE LIGJORE

- Unë nëpërmjet kësaj deklaroj se do të ushtroj aktivitet në fushën e komunikimeve elektornike të shënuara me sipër dhe të aplikoj për regjistrim në regjistrin e ofrueseve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike (sipërmarrësve) të AKEP.
- Unë nëpërmjet këtij dokumenti deklaroj se kam mbyllur aktivitetet e komunikimeve elektronike të shënuara më sipër.
- Unë nëpërmjet këtij dokumenti deklaroj se kam mbyllur çdo aktivitet të komunikimeve elektronike nën regjimin e Autorizimit të Përgjithëm dhe marr përsipër te shlyej te gjitha detyrimet financiare ndaj AKEP.
- Unë nëpërmjet ketij dokumenti deklaroj se të dhënat e mia kanë pësuar ndryshime, sikurse përshkruhen në formular.
- Unë nëpërmjet këtij dokumenti deklaroj se kam ndryshuar formën ligjore të kompanisë sime sic përshkruhet në formular. Emri i vjetër është si më poshtë:

Unë nëpërmjet këtij dokumenti paraqes në AKEP të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor dhe/ose të gjithë dokumentat që sigurojnë se nënshkruesi i këtij Njoftimi Regjistrimi ka lidhje me personin përfaqësues.

Unë deklaroj se informacioni që perfsihet në deklarinimin e paraqitur, sikurse çdo informacion tjetër shoqërues, është i saktë dhe i vërtetë, dhe jam plotësisht i vetëdijshëm për faktin që, lidhur me angazhimin në çdo aktivitet të komunikimeve elektronike për të cilin është e nevojshme të sigurosh të drejtën e përdorimit për numeracion dhe frekuenca, të drejta të cilat nuk sigurohen nëpërmjet kësaj procedurë, unë duhet të paraqes një aplikim për të fituar të drejtat e përdorimit të cituara më sipër përpara fillimit të ofrimit të shërbimit.

Data e Aplikimit:

/ /

Nënshkrimi dhe Vula

Vendi:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

CERTIFIKATË

E

KONFIRMIMIT TË NJOFTIMIT

Nr. ____ /datë __. __. ____

SIPËRMARRËSI “XXXXXXXXX”

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare konfirmon se sipërmarrësi “XXXXXXXXX” me adresë: XXXXXX, ka paraqitur Njoftimin e Regjistrimit sipas Nenit 14 të Ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe është regjistruar në Regjistrin e Siperarrësve për ofrimin e rrjeteve dhe të shërbimeve publike te komunikimeve elektronike sipas Regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm:

KRYETARI

(nënshkrimi & vula e autoritetit)

**Rrjete dhe shërbime publike të komunikimeve elektronike
të njoftuara në AKEP nga sipërmarrësi “xxxxxxx”**

A. Rrjete publike të komunikimeve elektronike:

a)
.....

B. Shërbime publike të komunikimeve elektronike:

b)
.....

Sipërmarrësi i regjistruar për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike të mësipërme, i cili operon nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm, është i detyruar të zbatojë termat dhe kushtet e parashtuara në Aneksin E të Rregullores së Autorizimit të Përgjithshëm.

Në faqen e internetit AKEP publikon një regjistër të përditësuar i të gjithë sipërmarrësve të cilët kanë njoftuar ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, duke përfshirë informacionin mbi llojet e rrjeteve dhe shërbimeve që ata ofrojnë.

Nr. _____ X-X / datë XX.XX.20XX





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

CERTIFIKATË
E
KONFIRMIMIT TË NJOFTIMIT

Nr._____/datë____.____.____

SIPËRMARRËSI “XXXXXXXX”

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare konfirmon se sipërmarrësi “XXXXXXXX” me adresë: XXXXXX, ka paraqitur Njoftimin e Regjistrimit sipas Nenit 14 të Ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe është regjistruar në Regjistrin e Sipërmarrësve për ofrimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike sipas Regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm, për ofrimin e rrjetit për transmetim audio dhe/ose audiovizive sipas Ligjit Nr. 97/2013, date 04.03.2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

KRYETARI

(nënshkrimi & vula e autoritetit)

Rrjete të komunikimeve elektronike për transmetimin e programeve audio dhe/ose audiovizive të njoftuara në AKEP nga sipërmarrësi “xxxxxxx”

A. Rrjete te komunikimeve elektronike:

1. Rrjete kabllore televizive:

a)
.....

2. Rrjete satelitore:

a)
.....

3. Zona e ofrimit të rrjetit:

a)
.....

Sipërmarrësi i regjistruar për ofrimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të mësipërme, i cili operon nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm, është i detyruar të zbatojë termat dhe kushtet e parashtruara në Aneksin E të Rregullores së Autorizimit të Përgjithshëm dhe dispozitat e Ligjit Nr. 97/2013, datë 04.03.2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

Në faqen e internetit AKEP publikon një regjistër të përditësuar i të gjithë sipërmarrësve të cilët kanë njoftuar ofrimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike për transmetimin e programeve audio dhe/ose audiovizive, duke përfshirë informacionin mbi llojet e rrjeteve që ata ofrojnë.

Nr. _____ . X-X / datë XX.XX.20XX

— —



ANEKSI D

REGJISTRI (*database*) I PËRDITËSUAR I SIPËRMARRËSVE/SUBJEKTEVE QË KANË NJOFTUAR OFRIMIN E RRJETEVE DHE SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

TIP



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

REGJISTRI I SIPËRMARRËSVE QË KANË NJOFTUAR OFRIMIN E RRJETEVE DHE SHËRBIMEVE PUBLIKE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE SIPAS REGJIMIT TË AUTORIZIMIT TË PËRGJITHSHËM DERI NË DATËN _____

Emri i sipërmarrësit	Numri i Çertifikatës dhe data	Rrjetet/Shërbimet e regjistruara	Të dhëna të sipërmarrësit				
			Data e deklarimit të fillimit të rrjetit/shërbimeve	NIPT-i	Përfaqësuesi ligjor	Adresa e sipërmarrësit	Të dhëna kontakti

ANEKSI D/1

**REGJISTRI (database) I PËRDITËSUAR I SUBJEKTEVE QË KANË NJOFTUAR
OFRIMIN E RRJETEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE
PËR
TRANSMETIMET AUDIO DHE/OSE AUDIOVIZIVE**

TIP



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

**REGJISTRI I SIPËRMARRËSVE QË KANË NJOFTUAR OFRIMIN E RRJETEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE
PËR TRANSMETIM AUDIO DHE/OSE AUDIOVIZIVE SIPAS REGJIMIT TË AUTORIZIMIT TË PËRGJITHSHËM
DERI NË DATËN _____**

Emri i sipërmarrësit	Numri i Çertifikatës dhe data	Rrjetet/Shërbimet e regjistruara	Të dhëna të sipërmarrësit				
			Data e deklarimit të fillimit të rrjetit/shërbimeve	NIPT-i	Përfaqësuesi ligjor	Adresa e sipërmarrësit	Të dhëna kontakti

ANEKS E

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR OFRIMIN E RRJETEVE DHE SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

Në zbatim të nenit 15 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar (*ligji nr. 9918*), për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm AKEP vendos,

KUSHTET E PËRGJITHSHME:

I. DISPOZITA PARAPRAKE:

1. Kushtet e Përgjithshme vendosen nga AKEP në autorizimin e përgjithshëm, të cilat çdo sipërmarrës/subjekt i autorizuar sipas ligjit nr. 9918 për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike publike, është i detyruar t’i zbatojë tërësisht apo pjesërisht, në varësi të rrjetit dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike që do të ofrojnë sipas Njoftimit të regjistrimit.

2. AKEP në Certifikatën e Konfirmimit të Njoftimit, në referencë me Kushtet e Përgjithshme të përcaktuara në këtë Rregullore (Aneksi E) përcakton kushtet e përgjithshme që do të zbatojë sipërmarrësi sipas llojit dhe karakterit të rrjetit dhe/ose shërbimit të komunikimeve elektronike që do të ofrojë.

3. Përveç kushteve të përgjithshme, AKEP sipas rastit dhe nevojës, në zbatim të ligjit nr. 9918, akteve nënligjore në zbatim të tij dhe legjislacionit në përgjithësi, mund të vendosi për sipërmarrësit edhe kushte të veçanta, të detyrueshme për t’u zbatuar.

4. Në varësi të ndryshimeve që mund të ndodhin sipas njoftimit të sipërmarrësit në lidhje me ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike, AKEP rivlerëson edhe nevojën e ndryshimit (shtimin ose pakësimin) të kushteve të përgjithshme ose të veçanta të vendosura për sipërmarrësin.

II. DISPOZITA MATERIALE:

1. Kontributi financiar për financimin e shërbimit universal:

1.1 Disponueshmëria e shërbimit universal garantohet me ligj. AKEP në zbatim të përcaktimeve ligjore të parashikuara në Kreun V të ligjit nr. 9918 merr masat e duhura rregulluese me akt rregullator për këtë qëllim, bazuar në parimet e objektivitetit, transparencës, mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit, për garantimin e ofrimit të shërbimit universal, me sa më pak dëmtime të mundshme të tregut, në veçanti nga ofrimi i shërbimeve me çmime, terma dhe kushte të tjera nga ato të ofruara nga tregu për qëllim të interesit publik.

1.2 Për kompesimin e kostove të shërbimit universal krijohet fondi i këtij shërbimi. Fondi i Shërbimit Universal menaxhohet dhe administrohet nga AKEP. Ky fond është i paprekshëm për qëllime të tjera dhe, nëse nuk shpenzohet, akumulohet dhe mbartet në vitin pasardhës.

1.3 Fondi i Shërbimit Universal krijohet nga sipërmarrësit, që zotërojnë rrjete të komunikimeve elektronike publike dhe ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike publike dhe ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me rregulloren e AKEP.

1.4 AKEP, me vendim të Këshillit Drejtues përcakton, kuotën e financimit, e cila për të gjithë sipërmarrësit, subjekt i pagesës, nuk do të jetë më e lartë se 1% e totalit të të ardhurave, të siguruar nga rrjetet e komunikimeve elektronike publike dhe ofrimi i shërbimeve të komunikimeve elektronike publike.

1.5 AKEP mund të përcaktojë një ose më shumë sipërmarrës për të garantuar ofrimin e Shërbimit Universal sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 9918, në mënyrë që i gjithë territori i vendit të jetë i mbuluar. AKEP mbi bazën e rezultateve të Dokumentit rregullator për Statusin e Shërbimit Universal, mund të përcaktojë sipërmarrës të ndryshëm ose një bashkim sipërmarrësish për ofrimin e elementëve të ndryshëm të Shërbimit Universal dhe/ose për mbulimin e pjesëve të ndryshme të territorit të vendit.

1.6 Rregullat për përcaktimin e ofruesit/esve të Shërbimit Universal miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Bashkëveprimi i shërbimeve dhe interkoneksioni i rrjeteve:

2.1 Rrjeti i komunikimeve elektronike publike ndërtohet për të mbështetur shërbimet e komunikimeve elektronike publike dhe funksionon si rrjet mbarëkombëtar, pa dallim, për të gjithë përdoruesit, i hapur për të gjithë sipërmarrësit dhe i integruar në rrjetin ndërkombëtar, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

2.2 Bashkëveprimi i shërbimeve dhe interkoneksioni i rrjeteve parimisht përbën detyrim ligjor për të gjithë sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike publike. AKEP, në përputhje me përcaktimet ligjore të parashikuara në ligjin nr. 9918 plotëson kuadrin rregullator me aktet e nevojshme për të siguruar zbatimin e këtij detyrimi nga sipërmarrësit.

2.3 Cilido sipërmarrës i autorizuar nga AKEP-i për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike ka të drejtë të negociojë interkoneksionin dhe të marrë akses ose të interkonektohet me sipërmarrës të tjerë që operojnë nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm.

2.4 Procedura dhe rregullat për aksesin dhe interkoneksionin zbatohen nga sipërmarrësit në përputhje të plotë me ligjin nr. 9918 dhe dokumentat rregullatore të nxjerra dhe miratuara nga AKEP-i:

i) Rregullore Nr. 19, datë 14. 06. 2010 “Për aksesin dhe interkoneksionin” (**Rregullore nr. 19**);

ii) RIO e publikuar e operatorëve me FNT;

iii) RUO e publikuar e operatorëve me FNT.

iv) çdo vendim i AKEP-it i nxjerrë për këtë qëllim.

2.5 Për realizimin e interkoneksionit dhe/ose aksesit sipërmarrësit lidhin midis tyre marrëveshje interkoneksioni dhe/ose aksesit, një kopje e të cilave depozitohet në AKEP brenda 15 ditëve nga data e lidhjes së tyre..

2.6 Në çdo rast, marrëveshjet e interkoneksionit dhe aksesit duhet të jenë në përputhje me ligjin nr. 9918, legjisllacionin në tërësi dhe aktet e AKEP-it për këtë qëllim.

2.7 Çdo sipërmarrës i rrjeteve të komunikimeve elektronike publike, duhet që, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së një kërkesë, t’u japë një ofertë interkoneksioni (RIO) sipërmarrësve të tjerë të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike, që të sigurojë komunikimin e përdoruesve, ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe bashkëveprimin e shërbimeve në të gjithë komunitetin.

2.8 AKEP, në përputhje me objektivat rregullatorë nxit dhe nëse është e nevojshme, detyron realizimin e aksesit dhe interkoneksionit, si dhe bashkëveprimin e shërbimeve, duke synuar nxitjen e konkurrencës së qëndrueshme dhe efçente, për përfitimin maksimal të përdoruesve fundorë.

2.9 Pavarësisht nga masat që mund të merren ndaj sipërmarrësve me FNT, në përputhje me nenin 34 të ligjit nr. 9918, AKEP vendos:

a) ndaj sipërmarrësve, të cilët kontrollojnë aksesin te përdoruesit fundorë, detyrimin në masën e duhur, për të siguruar lidhjen pikë fundore – pikë fundore, duke përfshirë, në rastet e justifikuara, detyrimin për të interkonektuar rrjetet e tyre në mungesë të këtij interkoneksioni;

b) në rastet e justifikuara dhe në masën e duhur, detyrimin ndaj sipërmarrësve, të cilët kontrollojnë aksesin te përdoruesit fundorë për të mundësuar ndërveprueshmërinë e këtyre shërbimeve.

2.10 Caktimi i kodeve të sinjalizimit kombëtar (NSPC) dhe ndërkombëtar (ISPC):

a) Sipërmarrësi që kërkon të ofrojë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike, përpara fillimit të ofrimit të tyre, për realizimin e interkoneksionit duhet të pajiset me NSPC.

b) Nëse sipërmarrësi do ta realizojë interkoneksion ndërkombëtar bazuar në sinjalizimin SS7, atëherë, duhet detyrimisht të pajiset edhe me kodin ISPC.

c) Caktimi nga AKEP-i i NSPC dhe ISPC bëhet mbi bazën e Rregullores Nr. 17, datë 16.04.2010 “Rregullat për administrimin e kodeve të pikave të sinjalizimit kombëtar (NSPC) dhe ndërkombëtar (ISPC) për interkoneksionin e rrjeteve” (*Rregullore nr. 17*).

d) Për caktimin nga AKEP të NSPC dhe ISPC, sipërmarrësi duhet të aplikojë sipas përcaktimeve të Rregullores nr. 17 njëkohësisht me fillimin e aplikimit për Njoftim regjistrimi përcaktuar në këtë rregullore. Për caktimin e ISPC sipërmarrësi përpara fillimit të aplikimit duhet të ketë siguruar dhe disponojë një marrëveshje paraprake me operatorin/ët ndërkombëtarë ku do të jetë vendosur edhe ISPC që disponon ky operator ndërkombëtar.

e) Sipërmarrësit e pajisur nga AKEP-i me NSPC dhe ISPC, duhet:

i) të përdorin kodet e caktuar nga AKEP në përputhje me kushtet e vendosura në vendimet përkatëse të AKEP-it, Rregullat për administrimin e kodeve të pikave të sinjalizimit kombëtar (NSPC) dhe ndërkombëtar (ISPC) për interkoneksionin e rrjeteve, dhe dispozitat e kësaj Rregulloreje si dhe detyrimet financiare përkatëse.

3. Sigurimi i disponueshmërisë dhe kushtet e përdorimit të numrave nga plani i numeracionit për akses në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike publike:

3.1 Numrat për akses në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike janë burim natyror të fundëm dhe për këtë qëllim administrimi i tyre duhet të sigurojë përdorim eficient, në përputhje edhe me vendimet përkatëse të organizmave ndërkombëtare dhe detyrimet që rrjedhin nga konventat ose nga marrëveshjet, ku Republika e Shqipërisë është palë.

3.2 Plani i numeracionit përcakton strukturën, gjatësinë dhe caktimin e numrave për akses në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve publike.

3.3 AKEP administron planin e numeracionit në mënyrë që:

a) të sigurojë strukturimin dhe përdorimin eficient të numrave dhe serive numerike;

b) të kënaqë nevojat e arsyeshme të operatorëve dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike për caktim të numrave, sipas këtij ligji;

c) të sigurojë që caktimi dhe përdorimi i numrave bëhet në mënyrë të ndershme, transparente dhe jodiskriminuese.

3.4 Numrat dhe seritë numerike përdoren vetëm pas miratimit nga AKEP, në përputhje me rregullat përkatëse.

3.5 Në rast se sipërmarrësi për ofrimin e rrjeteve dhe ose shërbimeve elektronike publike do të përdorë numra dhe seri numerike, atëhere sëbashku me njoftimin për regjistrim duhet të aplikojë në AKEP-i sipas dhe Rregulloren Nr. 10, datë 11. 08. 2009 “Për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike”, të ndryshuar (**Rregullore nr. 10**).

3.6 Mbajtësi i autorizuar nga AKEP i të drejtës së përdorimit të numrave është i detyruar t’i përdori ato vetëm sipas kushteve të vendosura nga AKEP në përputhje me ligjin nr. 9918, Planin Kombëtar të Numeracionit dhe Rregulloren nr. 10.

3.7 Mbajtësi i autorizuar nga AKEP i të drejtës së përdorimit të numrave:

- a) është i detyruar të kthejë numrat apo seritë numerike të caktuara, në rast se ato nuk janë në përdorim;
- b) nuk mund të përdorë numrat dhe seritë numerike, të caktuara për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat janë dhënë;
- c) nuk mund të transferojë apo t’i japi me qira numrat apo seritë e numrave të caktuara, pa miratimin paraprak të AKEP;
- ç) mund t’i transferojë numrat dhe seritë numerike të caktuara së bashku me veprimtarinë e ushtruar, kur mbajtësi i ri përmbush kërkesat për përdorimin e numrave dhe të serive numerike, në përputhje me vendimet e AKEP;
- d) është i detyruar të paguajë pagesat për numeracion, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
- e) duhet të përmbushi kërkesën për transferimin e numeracionit në të gjitha rastet kur kërkohet një gjë e tillë;
- ë) është i detyruar të përdorë numrat apo seritë e numrave vetëm për qëllimin për të cilin i janë dhënë dhe të mos i shkaktojë dëm ndonjë grupi të caktuar përdoruesish;
- f) të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga aktet ndërkombëtare, të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë, për caktimin dhe përdorimin e numrave.
- g) të mos bëjë diskriminime të pajustificuara lidhur me sekuencen e numrave dhe grupeve të numrave ndërmjet pajtimtarëve.

3.8 AKEP mund të heqë të drejtën për përdorim të numrave dhe serive të numrave në rast se vëren se mbajtësi të drejtës për përdorim të numrave dhe serive numerike:

- a) nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9918, për caktimin e numrave dhe serive numerike;
- b) nuk ka kryer në kohë pagesën vjetore për përdorimin e numrave dhe të serive numerike;
- c) nuk ka filluar t’i përdori ato brenda 3 vjetëve nga data e caktimit të tyre.

3.9 AKEP mund ta heqë të drejtën për përdorim të numrave dhe serive numerike me kërkesë të mbajtësit të së drejtës për përdorimin e numrave apo serive numerike.

3.10 Mbajtësit e të drejtave për përdorimin e numrave dhe të serive numerike paguajnë pranë AKEP një pagesë vjetore për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe të serive numerike, neni 119 i ligjit 9918. Niveli i pagesës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Portabiliteti i numrave:

4.1. Sipërmarrësit e rrjeteve telefonike publike janë të detyruar të krijojnë në rrjetet e tyre mundësinë që pajtimtarët të mbartin numrin e tyre të telefonit, pavarësisht nga sipërmarrësi që u ofron shërbimin telefonik, si më poshtë:

- a) në rastin e numrave gjeografikë – në një rajon të caktuar;
- b) në rastin e numrave jogjeografikë – në çdo rajon.

4.2 Detyrimi sipas pikës së mësipërme 5.1 zbatohet për të gjithë numrat e Planit të Numeracionit. AKEP mund të përcaktojë seri numrash, të cilat nuk janë subjekt i mbartjes së numrit.

4.3 AKEP në zbatim të detyrimit ligjor nëpërmjet Rregullores nr. 43 datë 22.09.2016 “Për

mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit” (*Rregullore nr. 43*) ka përcaktuar mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit.

5. Numeracioni për shërbimet e thirrjeve të emergjencës:

5.1 Të gjithë sipërmarrësit e rrjeteve publike telefonike janë të detyruar t’u sigurojnë përdoruesve të tyre të shërbimit telefonik të disponueshëm për publikun, përfshirë përdoruesve të telefonave publikë me pagesë, dërgimin pa pagesë të thirrjeve drejt numrave të emergjencës, në mënyrë të veçantë duhet t’iu mundësojnë përdoruesve aksesin në numrin e emergjencës “112”.

5.2 Të gjithë sipërmarrësit e rrjeteve publike telefonike ose shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun janë të detyruar të lejojnë thirrjet pa pagesë drejt shërbimeve të emergjencës dhe, në se është e mundur teknikisht, të sigurojnë identifikimin e numrit thirrës dhe informacionin për vendodhjen e tij.

5.3 Në mënyrë të veçantë, Ofruesit e Shërbimit Telefonik Publik janë të detyruar të sigurojnë pa pagesë gjithë informacionin e nevojshëm për identifikimin e vendndodhjes së personit që ka thirrur autoritetet kompetente në mënyrë që të veprojnë me emergjencë, për të gjitha thirrjet e bëra në numrin e emergjencës “112”.

5.4 Ofruesit e Shërbimit Publik Telefonik që ofrojnë Shërbime të Mesazheve të Shkurta (SMS), në mënyrë që t’u shërbejnë personave që kane probleme serioze me të folurit dhe dëgjimin, janë të detyruar të sigurojnë akses në shërbimet e emergjencës pa pagesë nëpërmjet Shërbimit të Mesazheve të Shkurtra (SMS).

6. Mbrojtja e mjedisit, planifikimi territorial, aksesin në pronat e patundshme, bashkëvendosja ose përdorimi i përbashkët i pajisjeve:

6.1 Rrjetet e komunikimeve elektronike dhe infrastruktura shoqëruese me to duhet të ndërtohen dhe shfrytëzohen në përputhje me ligjin nr. 9918 dhe me aktet në zbatim të tij, me legjislacionin në fuqi për planifikimin territorial dhe ndërtimin, për mbrojtjen e mjedisit, si dhe me standardet e tjera teknike.

6.2 Sipërmarrësi ka të drejtë të përdorë tokë, troje ose objekte në pronësi të shtetit, përfshirë ndërtesat dhe kanalizimet e ndërtuara mbi ose nën to, të drejtat nënujore dhe ato të hapësirës ajrore, rrugët, liqenet, pyjet etj., për vendosjen e pajisjeve të komunikimeve elektronike, si dhe për mirëmbajtjen e tyre.

6.3 Pronësia ose të drejtat e tjera ndaj pronave të paluajtshme, në rastet ku ato janë me interes të veçantë për ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve të komunikimeve elektronike publike dhe infrastrukturës shoqëruese, shpronësohen ose kufizohen sipas procedurave dhe mënyrave të përcaktuara në ligjin nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit” (*ligji nr. 120/2016*) dhe legjislacionin referues sipas këtij ligji.

6.4 Rrjetet e komunikimeve elektronike publike duhet të planifikohen në mënyrë që të krijojnë sa më pak të jetë e mundur rreziqe dhe shqetësime ndaj pronës private.

6.5 Para fillimit të punimeve për ndërtimin ose mirëmbajtjen e rrjetit të komunikimeve elektronike publike, sipërmarrësit duhet të pajisen me lejet përkatëse nga autoritetet kompetente sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit Ligj nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (*ligji nr. 107/2014*), aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe lejet e mjedisit

sipas Ligj nr. 10 448, datë 14. 7. 2011 “Për lejet e mjedisit” (*ligji nr. 10 448*) dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

6.6 Sipërmarrësi detyrohet të shfrytëzojë pronat e mësipërme, në përputhje me ligjin nr. 10 431, datë 9. 6. 2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” (*ligji nr. 10431*) dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Me përfundimin e punimeve, kur është objektivisht e mundur, detyrohet ta kthiejë mjedisin në gjendjen e mëparshme.

6.7 Kur nga vendosja ose mirëmbajtja e pajisjeve të komunikimeve elektronike dëmtohet prona ose ndryshon funksioni i saj, sipërmarrësi detyrohet të shpërblejë dëmin, sipas legjislacionit në fuqi.

6.8 Sipërmarrësit, janë të detyruar që në rastet e ndërtimit të infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërurbane të komunikimeve elektronike, të zbatojnë Rregulloren e AKEP nr. 22, datë 24. 06. 2011 “Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërurbane të komunikimeve elektronike” (*Rregullore nr. 22*).

6.9 Në rastet kur kërkohet përdorimi ekonomik i hapësirave, planifikimi urban dhe mbrojtja e mjedisit, sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve publike elektronike, që kanë të drejtë të ndërtojnë dhe instalojnë pajisje komunikimi në mjedise private ose publike duhet t’i ndërtojnë ose instalojnë ato, për të mundësuar përdorimin e përbashkët të tyre.

6.10 Për përdorimin e përbashkët të të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike sipërmarrësit janë të detyruar të zbatojnë Rregullore nr. 35, datë 10. 07. 2015 “Rregulla për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike” (*Rregullore nr. 35*)

6.11 Sipërmarrësit e rrjeteve publike të komunikimeve janë të detyruar të lidhin marrëveshje për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve në kushtet e përcaktuara në pikën e mësipërme 6.10.

6.12 Refuzimi i kërkesës përpërdorim të përbashkët të faciliteteve dhe aseteve bëhet nga sipërmarrësi vetëm kur është në kushtet e përcaktuara në pikën 4 të nenit 22 të ligjit nr. 9918.

6.13 Kur sipërmarrësit e rrjeteve publike të komunikimit nuk arrijnë marrëveshje ndërmjet tyre, AKEP me kërkesë të çdo pale, ndërmerr një procedurë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas përcaktimeve të parashikuara në Rregulloren nr. 35 dhe akteve rregullatore në fuqi për këtë qëllim.

6.14 Sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve publike kanë detyrimin për dërgimin e informacionit në AKEP mbi infrastrukturën e rrjeteve dhe faciliteteve shoqëruese dhe përditësimit të tij në përputhje me rregulloren nr. 26. datë 16. 08. 2012 “Për përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*Rregullore nr. 26*)

7. Mbrojtja e të dhënave vetjake dhe privatësisë:

7.1 Sipërmarrësit që administrojnë të dhënat vetjake dhe personale të përdoruesve/pajtimtarëve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike që ata ofrojnë, kanë detyrimin ligjor të mbrojtjes së këtyre të dhënave dhe privatësisë në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9918 dhe ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” të ndryshuar (*ligji nr. 9887*).

7.2 Sipërmarrësit duhet të marrin masat ndaj sistemeve të komunikimeve elektronike dhe të përpunimit të të dhënave, për të mbrojtur sekretin e komunikimeve elektronike dhe të të dhënave vetjake, si dhe për të ndaluar aksesin e paautorizuar në sistemet e komunikimeve elektronike dhe të përpunimit të të dhënave.

7.3 Sipërmarrësit e rrjeteve dhe të komunikimeve elektronike janë të detyruar që, individualisht ose kur është e nevojshme, në bashkëpunim me njeri – tjetrin, të zbatojnë masa teknike dhe organizative, për të realizuar sigurinë e rrjeteve dhe/ose të shërbimeve, të ofruara prej tyre. Në mënyrë të veçantë duhet të merren masa për të parandaluar dhe minimizuar ndikimin e aksidenteve të sigurisë mbi përdoruesit e rrjeteve të ndërlidhura.

7.4 Rregullat e përcaktuara nga AKEP në rregullore nr. 37, datë 29. 10. 2015 “Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike” (**Rregullore nr. 37**) janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga të gjithë sipërmarrësit që disponojnë rrjete të komunikimeve elektronike dhe/ose që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike publike.

7.5 Sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike kanë detyrimin e zbatimit të kushteve dhe rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 9918, Rregullore e AKEP nr. 31, datë 26. 12. 2013 “Për termat e përgjithshme të kontratës së pajtimit për lidhjen dhe aksesin në rrjetin publik të komunikimeve elektronike” (**Rregullore nr. 31**) lidhur me:

- a) Konfidencialitetin e komunikimit;
- b) Administrimin e të dhënave për trafikun e komunikimit;
- c) Identifikimin e linjës thirrëse dhe të thirrur;
- d) Të dhënat për vendndodhjen;
- e) Ridrejtimin automatik të thirrjeve;
- f) Komunikimet pa kërkesë;
- g) Të dhënat e pajtimtarit.

8. Mbrojtja e konsumatorit:

8.1 Sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike publike kanë detyrimin ligjor të mbrojtjes së konsumatorit (përdoruesit/pajtimtarit) në përputhje me përcaktimet e parashikuara në ligjin nr. 9918, ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” të ndryshuar (**ligji nr. 9902**), si dhe aktet nënligjore dhe rregullatore të nxjerra në zbatim të tyre.

8.2 Sipërmarrësit e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike duhet të publikojnë informacion transparent, të krahasueshëm, të përshtatshëm dhe të përditësuar për tarifatat dhe çmimet e aplikuara, çdo detyrim në përfundim të kontratës, si dhe kushtet e përgjithshme për aksesin e përdorimit të shërbimeve të ofruara nga ata për përdoruesit fundorë në përputhje me ligjin nr. 9918 dhe Rregulloren e AKEP nr. 27, datë 21. 09. 2012 “Mbi publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike (**Rregullore nr. 27**).

8.3 Lidhja ose aksesin në rrjetin publik të komunikimeve elektronike sigurohet nga sipërmarrësit në bazë të kontratës që lidhet me pajtimtarët sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 9918 dhe Rregulloren nr. 31, si dhe bazohet në parimin e barazisë mes palëve.

8.4 Një kopje tip e kontratës së pajtimit, si dhe çdo ndryshim i mëvonshëm që mund të pësojë, i dërgohet AKEP 15 ditë përpara hyjes në fuqi të tyre.

8.5 Sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe/ose distributorët e autorizuar prej tyre për shitjen e kartave SIM, përpara aktivizimit të shërbimit detyrohen të bëjnë regjistrimin e pajtimtarëve të tyre, me kontratë pajtimi ose kartë të parapaguar. Formulari i regjistrimit nga sipërmarrësit të të dhënave të identifikimit të pajtimtarit, përcaktohet dhe miratohet nga AKEP në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9918.

8.6 Sipërmarrësit janë të detyruar të zbatojnë kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9918 dhe/ose legjisllacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, si dhe aktet e nxjerra nga AKEP lidhur me:

- a) Ruajtjen dhe administrimin e të dhënave për qëllime të ndjekjes penale;
- b) Shkatërrimin e të dhënave të ruajtura;
- c) Garantimin e aksesit të barabartë dhe mundësisë së zgjedhjes për përdoruesit me aftësi të kufizuar;
- d) Publikimin e informacionit të duhur, të krahasueshëm dhe të përditësuar për cilësinë e shërbimeve të ofruara prej tyre, *speed test* për matjen e kapacitetit *Broadband* të ofruar, etj.;
- e) Përfshirjen e pajtimtarit në numratorin telefonik të përgjithshëm;
- f) Organizimin dhe funksionimin e shërbimit të asistencës ndaj përdoruesve fundorë. Të gjithë përdoruesit fundorë, që kanë akses në rrjetin e komunikimeve elektronike publike, duhet të kenë akses në shërbimet e asistencës së sipërmarrësit;
- g) Ofrimin pa pagesë pajtimtarëve të shërbimeve të ofruara prej tyre të faturës së detajuar me qëllim që t'u mundësojnë kontrollin mbi shumën e faturuar;
- h) Sigurimin e ushtrimit të të drejtës së ankimit të pajtimtarit për kushtet kontraktore dhe/ose përmbushjen e këtyre kushteve, përfshirë faturën dhe cilësinë e shërbimit të ofruar.

8.7 Sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike publike, pa përjashtim, përpara fillimit të ofrimit të shërbit, kanë detyrimin e ndërtimit dhe ofrimit të faqes elektronike (*www....*) për publikimin e informacionit të kërkuar sipas ligjit nr. 9918 dhe legjisllacionit të përgjithshëm.

8.8 Çdo ofrues i shërbimeve publike telefonike duhet të sigurojë ekzistencën e procedurave për shqyrtimin e problemeve që hasen nga konsumatorët dhe duhet të ketë departamentet e shërbimit të konsumatorit ose personel të trajnuar në mënyrë të duhur dhe speciale në pikat e tij të shitjes.

8.9 Në bashkëpunim edhe me AKEP, ofruesit e shërbimit publik telefonik duhet të bëjnë një grupim të problemeve/pyetjeve që janë drejtuar tek departamenti i shërbimit të konsumatorit nga Përdoruesit dhe duhet të trajtojë personelin e shërbimit të konsumatorit që të jetë i aftë të trajtojë efektivisht, në mënyrë të standardizuar, të paktën çështjet e ndeshura me shpesh të përfshira në cilëndo kategori.

8.10 Ndër të tjera, ofruesit e shërbimit publik telefonik duhet t'i shërbejnë përdoruesit lidhur me çështjet e difekteve nëpërmjet një linje speciale pa pagesë e cila të punojë të paktën 12 orë në ditë, nga e Hëna deri të Shtunë.

9. Respektimin e kufizimeve në lidhje me përmbajtjet e paligjshme ose të dëmshme:

9.1 Për transmetimet e përcaktuara me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme mbi bazën e një vendimi të marrë nga organet kompetente të parashikuara në legjisllacionin respektiv, zbatohen kufizime.

9.2 Sipërmarrësi/subjekti që ofron rrjetin dhe ose shërbimin/et e komunikimeve elektronike, ka detyrimin ligjor që të marrë masat e duhura juridike dhe teknike për zbatimin e kufizimit të kërkuar.

9.3 AKEP, me disponimin e kërkesës së organit kompetent të fushës për kufizimin e transmetimit me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme, i drejtohet sipërmarrësit, subjektit që ofron rrjetin dhe/ose shërbimet e komunikimit elektronik publik, për ndërprerjen dhe bllokimin e transmetimit të kësaj përmbajtje.

9.4 Me marrjen e kërkesës nga AKEP për kufizimin e transmetimit me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme, sipërmarrësi është i detyruar të veprojë menjëherë për ndërprerjen dhe bllokimin e transmetimit.

10. Dhënia e informacionit i cili duhet të paraqitet:

- në procedurën e Njoftimit sipas nenit 14 të ligjit nr. 9918 dhe kësaj Rregullore;
- në procedurën për dhënien e së drejtës së përdorimit të burimeve të fundme (frekuenca dhe numeracion);
- në AKEP dhe në organet e tjera, sipas nenit 16 të ligjit nr. 9918.

10.1. Njoftimi i regjistrimit për ofrimin e rrjetit dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike aplikuesi shoqërohet me informacionin e përcaktuar në nenin 14 të ligjit nr. 9918 dhe këtë rregullore .

Paraqitja e informacionit mbi:

- a) emrin dhe adresën e aplikuesit/sipërmarrësit,
- b) të dhënat e regjistrimit ligjor të sipërmarrësit në regjistër sipas ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar;
- c) personat e kontaktit të sipërmarrësit;
- ç) përshkrimin e shkurtër të rrjetit ose shërbimit të komunikimeve elektronike që do të ofrojë, sipas përcaktimeve të parashikuara në Aneksin B të kësaj rregullore.;
- d) datën kur është parashikuar fillimi i ofrimit të rrjetit ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të njoftuara;

si dhe çdo informacion tjetër të kërkuar në *Formularin e Njoftimit Online sipas Aneksit B*.

përbën kërkesë ligjore dhe është i detyrueshëm për t’u zbatuar.

10.2. Kur ofrimi i rrjetit dhe shërbimit të komunikimeve elektronike të parashikuara mbështetet në përdorimin e frekuencave sipas Planit Kombëtar të Frekuencave (**PKF**) dhe Planit të Përdorimit të Frekuencave (**PPF**) aplikuesi është i detyruar të pasijet me lejen e përdorimit të tyre nga AKEP.

Në këto raste sipërmarrësi/subjekti është i detyruar që njëkohësisht me procedurën e regjistrimit të njoftimit sipas kësaj rregullore, të zbatojë edhe procedurën *on line* për dhënien nga AKEP të së drejtës për përdorimin e frekuencave nëpërmjet autorizimit individual.

10.3. Procedura dhe informacioni që duhet të japi aplikuesi për t’u pajisur me autorizim individual për përdorimin e frekuencave përcaktohen në Rregullore nr. 30, datë 05. 12. 2013 “Për dhënien e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave” (**Rregullore nr. 30**).

10.4. Në rastet kur ofrimi i rrjetit dhe shërbimit të komunikimeve elektronike të parashikuar ka nevojë për përdorimin e numrave dhe serive numerike të cilat sipas Planit të Përdorimit të Numrave (PPN) lejohen të përdoren vetëm me autorizimin e AKEP, atëherë aplikuesi është i detyruar që njëkohësisht me procedurën e regjistrimit të njoftimit sipas kësaj rregullore, të zbatojë edhe procedurën *on line* për dhënien nga AKEP të së drejtës për përdorimin e numrave.

10.5. Procedura dhe informacioni që duhet të japi aplikuesi për t’u pajisur me autorizim për përdorimin e numrave dhe serive numerike përcaktohen në Rregullore nr. 10, datë 11. 08. 2009 “Për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike” të ndryshuar (**Rregullore nr. 10**).

10.6 Sipërmarrësit/subjektet që ofrojnë rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike janë të detyruar që t’i japin AKEP, me kërkesën e tij çdo informacion të nevojshëm për të përmbushur detyrimet funksionale të AKEP, sipas ligjit nr. 9918.

10.7 AKEP me akt rregullator, Rregullore nr. 12, datë 07. 04. 2010 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike” të ndryshuar (**Rregullore nr. 12**) përcakton informacionin të cilin sipërmarrësit/subjektet janë të detyruar ta dërgojnë në AKEP sipas formës, afatit dhe procedurës së kërkuar *on line* për qëllime statistikore, të kryerjes së analizës së tregjeve, monitorimit dhe vlerësimit të ecurisë së tregut, etj.

10.8 Informacioni mbi mënyrën e publikimit të tarifave dhe shërbimeve dërgohet nga sipërmarrësit në AKEP sipas përcaktimeve të parashikuara në Rregullore nr. 27.

10.9 Informacioni me të dhënat mbi cilësinë e ofrimit të rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike për përdoruesit, paraqitet dhe dërgohet nga sipërmarrësit në AKEP sipas afateve, procedurës dhe formës së përcaktuar në Rregullore nr. 16, datë 16. 04. 2010 “Për treguesit e cilësisë së shërbimit” (**Rregullore nr. 16**).

10.10 Informacioni mbi të dhënat e rrjeteve të komunikimeve elektronike paraqitet dhe dërgohet në AKEP në përputhje me procedurën dhe formën e përcaktuar në Rregullore nr. 26.

10.11 Informacioni mbi sigurinë e rrjeteve dhe incidentet e sigurisë dërgohet nga sipërmarrësit/subjektet e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike sipas procedurës së përcaktuar në Rregulloren nr. 37.

10.12 Përveç sa më sipër, AKEP me akte rregullatore të përgjithshme ose individuale, mund t’iu kërkojë sipërmarrësve/subjekteve informacione të tjera në përputhje me nevojën e përmbushjes së funksioneve dhe kompetencave ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 9918.

10.13 Sipërmarrësit, të cilët ofrojnë rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike, janë të detyruar t’i paraqesin ministrit, me kërkesën e tij, të gjithë informacionin e nevojshëm për të përmbushur detyrat funksionale të ministrit, sipas ligj nr. 9918. Ministri nxjerr udhëzim për të dhënat statistikore që raportohen pranë tij.

10.14 Sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, detyrohen që t’iu venë pa vonesë në dispozicion, edhe në formë elektronike, autoriteteve që përcakton Kodi i Procedurës Penale, në bazë të kërkesës së tyre, informacionin me skedarët e të dhënave për pajtimtarët, sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 101 të ligjit nr. 9918.

11. Lejimi i përgjimit nga organet kompetente:

11.1 Sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike kanë detyrimin e zbatimit të kërkesave dhe kushteve të përcaktuara në ligjin specifik për përgjimet lidhur me përgjimin e ligjshëm të komunikimeve elektronike, ligj nr. 9157, datë 4. 12. 2003 “Për përgjimin e telekomunikimeve” të ndryshuar (**ligji nr. 9157**).

11.2 Janë të ndaluara të gjitha format e mbikëqyrjes, përgjimit, ndërprerjes, regjistrimit, ruajtjes, transferimit dhe devijimit të komunikimeve si dhe të dhënat që përfshihen sipas ligjit nr. 9918 në konfidencialitetin e komunikimit, përveç rasteve kur kjo është e nevojshme për përcjelljen e mesazheve, të faksit, të postës elektronike, të sekretarisë telefonike, mesazheve zanore, mesazheve të shkurtra apo për rastet e parashikuara me ligj.

12. Kushtet për ofrimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike në rastet e gjendjes së emergjencës apo të gjendjes së luftës:

12.1 Sipërmarrësit detyrohen që, me rrjetet dhe shërbimet, të përballojnë nevojat e shtetit në situatë të jashtëzakonshme dhe kur e kërkojnë interesat e mbrojtjes kombëtare e sigurisë së rendit publik.

12.2 Sipërmarrësit, që ofrojnë akses në rrjetet e komunikimeve elektronike publike dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike të vlefshme për publikun, hartojnë dhe paraqesin në AKEP një plan, për të siguruar integritetin e rrjetit të komunikimeve publike dhe akses në shërbimet e komunikacioneve publike, të zbatueshme në situatë të jashtëzakonshme.

12.3 Në kuptim të ligjit nr. 9918, me situatë të jashtëzakonshme kuptohen dëmtime të rënda të rrjetit, fatkeqësitë natyrore, gjendja e emergjencës ose gjendja e luftës.

12.4 Plani që paraqesin sipërmarrësit sipas pikës 12.2 duhet të sigurojnë akses të pandërprerë dhe përdorimin e numrave të emergjencës dhe detyron sipërmarrësit të zbatojnë masat emergjente përgjatë gjithë kohëzgjatjes së situatës së jashtëzakonshme.

12.5 Sipërmarrësit detyrohen të bashkëveprojnë ndërmjet tyre dhe me organizatat qeveritare, ndërqeveritare dhe jofitimprurëse për përdorimin e burimeve të komunikimeve elektronike, për lehtësimin dhe përballimin e rasteve të veçanta, duke :

a) vendosur pajisje të komunikimit tokësor dhe satelitor për parandalimin, mbikëqyrjen dhe sigurimin e parandalimit të dëmeve natyrore, fatkeqësive në përgjithësi e atyre shëndetsore në veçanti;

b) shpërndarë njoftime për shkatërrimet natyrore, fatkeqësitë shëndetsore ndërmjet organizmave të lidhur me to dhe përhapjen e të dhënave në publik, veçanarisht në komunitetet që rrezikojnë më tepër;

c) vendosur dhe vënë në punë shërbimet e komunikimeve elektronike fleksibël, që përdorin organizatat humanitare.

12.6 Për lehtësimin e realizimit të masave të mësipërme, sipërmarrësit mund të lidhin marrëveshje të veçanta dhe të vendosin pagesa të veçanta ose të nënshkruajnë shtesa në marrëveshjet e kzistuese.

12.7 Ofruesit e shërbimit universal janë të detyruar të përcaktojnë paraprakisht personelin e tyre, që siguron shërbimin universal të pandërprerë në rast grevash, si dhe për përmbushjen e detyrimeve të sipërmarrësit në përputhje me parashikimet e pikës 12.5 të mësipërme.

13. Mbrojtja e shtetsave ndaj veprimeve të dëmshme të rrezatimit elektromagnetik, të përhapur nga rrjetet e komunikimeve elektronike:

13.1 Sipërmarrësit që ofrojnë rrjete të komunikimeve elektronike janë të detyruar të sigurojnë mbrojtjen e shtetasve ndaj veprimeve të dëmshme të rrezatimit elektromagnetit të përhapur nga rrjete e komunikimeve elektronike në përputhje me ligjin nr. 9918, ligjin nr. 10 459, datë 13. 10. 2011 “Për mbrojtjen nga rrezatimet johonizuese” (*ligji nr. 10 469*), ligjin nr. 10 489, datë 15. 12. 2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” (*ligji nr. 10 489*) dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre.

13.2 Sipërmarrësit që ofrojnë rrjete të komunikimeve elektronike, për pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacioneve kanë detyrimin e zbatimit të rregullit teknik në përputhje me Vendim nr. 546, datë 13. 6. 2013 “Për miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet radio dhe fundore te telekomunikacioneve dhe njohjen e ndërsjelltë të vlerësimit të konformitetit të tyre” (*VKM nr. 546*) për kërkesat mbrojtëse lidhur me pajtueshmërinë elektromagnetike, sipas legjislacionit në fuqi për përputhshmërinë elektromagnetike.

13.3 Aparati sipas kuptimit të përcaktuar në VKM nr. 546, i cili është importuar dhe i vendosur në treg dhe/ose në shërbim, nuk duhet të krijojë fusha elektromagnetike mbi vlerat e parashikuara në rregulloret e pajisjeve radio dhe pajisjeve fundore të telekomunikacioneve.

13.4 Vlerat limit të fushës elektromagnetike, vlerat limit të fuqisë së rrezatuar, si dhe kushte të tjera, të cilat duhet të plotësohen nga aparatet si burim i rrezatimit elektromagnetik të radiofrekuencave duhet të jenë sipas vlerave të miratuara.

14. Detyrimi për të ofruar akses:

14.1 Sipërmarrësit me FNT ndaj të cilëve AKEP ka vendosur detyrimin për akses duhet të plotësojnë kërkesat e arsyeshme për akses, në veçanti në ato raste kur AKEP vlerëson se nga

refuzimi i aksesit ose nga kushtet dhe termat e paarsyeshme, pengohet konkurrenca e qëndrueshme në tregun e pakicës, apo kur dëmtohen interesat e përdoruesve fundorë.

14.2 Sipërmarrësit me FNT në mënyrë të veçantë i kërkohet:

- a) t'u ofrojë palëve të treta akses në elementë të veçanta të rrjetit dhe/ose faciliteteve, duke përfshirë akses në elementë të rrjetit, të cilat nuk janë aktive dhe/ose akses të hapur në qarkun lokal, duke lejuar, ndërmjet të tjerash, zgjedhjen dhe/ose parazgjedhjen e bartësit dhe/ose ofertat e rishitjes së linjës së pajtimtarit;
- b) të ofrojë shërbime të veçanta në nivel shumice, për t'u rishitur nga palët e treta;
- c) të mos anulojë aksesin në facilitetet, kur e ka dhënë atë;
- ç) të negociojë me dëshirën e mirë dhe me mirëbesim me subjektet, që kërkojnë akses;
- d) të ofrojë akses të hapur në ndërfaqet teknike, protokollet ose teknologjitë e tjera të rëndësishme, të domosdoshme për ndërveprimin e shërbimeve;
- e) të ofrojë bashkëvendosje ose forma të tjera të përdorimit të përbashkët, pëfshirë ndërtesat, tubacionet kablore ose shtyllat, kullat;
- f) të ofrojë akses në sistemet mbështetëse funksionale ose sistemet e ngjashme ose sistemet e ngjashme informatike (*softëare*), të nevojshme, për të siguruar konkurrencë të ndershme, në ofrimin e shërbimeve;
- g) të krijojë kushtet e nevojshme për të siguruar ndërveprimin e shërbimeve pikë fundore – pikë fundore, duke përfshirë facilitetet për shërbimet e rrjetit inteligjent dhe/ose *roamingut* në rrjetet mobile;
- i) të interkonektojë rrjetet ose facilitetet e rrjetit;
- j) të ofrojë akses në shërbimet shoqëruese.

14.3 Për ofrimin e aksesit në rrjet në nivel shumice për palët e treta, sipërmarrësit janë të detyruar të zbatojnë rregullat e përcaktuara nga AKEP në Rregulloren nr. 19.

14.3 Sipërmarrësi me FNT, ndaj të cilit është vendosur detyrim për akses, sipas nenit 42 të ligjit nr. 9918, duhet t'u japë sipërmarrësve të tjerë, që kërkojnë akses në rrjetin e tij, një ofertë, që ata të ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike. Oferta e aksesit duhet të paraqitet pa vonesë, por në çdo rast, jo më vonë se 15 ditë dita e marrjes së kërkesës.

14.4 Sipërmarrësit, sigurojnë lidhjen ose aksesin në rrjetin publik të komunikimeve elektronike, në bazë të kontratës që lidhet me pajtimtarët në zbatim të legjislacionit në fuqi. Për hartimin dhe lidhjen e kontratës me pajtimtarin me qëllit realizimin e aksesit në rrjet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike publike që ofrojnë, sipërmarrësit janë të detyruar të zbatojnë përcaktimet e parashikuara në ligjin nr. 9918 dhe Rregulloren nr. 31.

14.5 Që t'iu mundësojnë pajtimtarëve aksesin në shërbimet e çdo ofruesi të shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun, me të cilët janë të interkonektuar, sipërmarrësit me FNT, në se AKEP e urdhëron, janë të detyruar të ofrojnë zgjedhjen ose parazgjedhjen e bartësit në përputhje me Rregulloren nr. 23, datë 29. 06. 2011 “Për zgjedhjen dhe parazgjedhjen e bartësit” (**Rregullore nr. 23**).

14.6 Cilido sipërmarrës që ofron rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike është i detyruar të publikojë specifikimet e ndërfaqeve të përdorura për ofrimin e shërbimeve.

14.7 Sipërmarrësit nuk mund të refuzojnë, për arsye teknike, një kërkesë të arsyeshme për lidhjen e një pajisjeje radio dhe pajisjet fundore të telekomunikacioneve. Rregullat teknike për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve radio dhe fundore të telekomunikacioneve përcaktohen në VKM nr. 546, Rregullore nr. 25, datë 14. 06. 2012 “Për pajisjet Radio dhe Fundore të telekomunikacioneve dhe Njohjen e Konformitetit të tyre” (**Rregullore nr. 25**) të cilat sipërmarrësit janë të detyruar t'i zbatojnë rigorozisht.

14.8 Të gjithë përdoruesit fundorë, që kanë akses në rrjetin e komunikimeve elektronike publike, duhet të kenë akses në shërbimet e asistencës së sipërmarrësit.

14.9 Ofruesit e shërbimit publik telefonik janë të detyruar të sigurojnë akses për çdo përdorues fundor të lidhur nëpërmjet rrjetit të tyre publik telefonik në shërbimet e postës zanore.

15. Mirëmbajtja e integritetit të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike:

15.1 Sipërmarrësi detyrohet të mbajë pajisjet e komunikimeve elektronike në gjendje të mirë pune, duke respektuar kushtet teknike dhe standardet përkatëse.

15.2 Gjatë përmbushjes së detyrave për mirëmbajtjen e pajisjeve të komunikimeve elektronike, punonjësit e autorizuar nga sipërmarrësi kanë të drejtë të hyjnë në pronat publike dhe private, për të kryer punimet e nevojshme dhe për të vënë shenjat e ndryshme, që tregojnë praninë e objekteve të komunikimeve elektronike.

15.3 Për të siguruar funksionimin normal të pajisjeve të komunikimeve elektronike, sipërmarrësi ka të drejtë të presë pemët, shkurret, degët e rrënjët, që rrezikojnë pajisjet e mësipërme, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore, si ligji nr. 120/2016, ligji nr. 10 448, ligji 107/2014 dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre.

15.4 Mirëmbajtja e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe infrastruktura shoqëruese me to duhet të jenë në përputhje me rregullat e ndërtimit për:

- a) përfundimin dhe përmirësimin e faciliteteve ekzistuese dhe të pajisjeve të rrjeteve publike të komunikimit;
- b) rindërtimin e sistemeve të antenave ekzistuese;
- c) rinovimin dhe rindërtimin e faciliteteve ekzistuese të rrjeteve të komunikimeve elektronike;
- ç) zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese apo instalimin e sistemeve të reja të komunikimit dhe rrjetet e aksesit publik;
- d) zgjerimin e sistemeve ekzistuese të furnizimit me energji elektrike.

16. Mbrojtja e rrjeteve të komunikimeve publike ndaj aksesit të paautorizuar:

16.1 Aksesit i paautorizuar në sistemet e komunikimeve elektronike dhe te perpunimit të të dhënave ndalohet me ligj. Sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike kanë detyrimin ligjor që të sigurojnë mbrojtjen e tyre ndaj aksesit të paautorizuar.

16.2 Sipërmarrësit, përpara fillimit të ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, sëbashku me informacionin për regjistrimin e Njoftimit, paraqesin në AKEP edhe informacionin mbi masat që do të zbatohen për mbrojtjen e rrjetit për të ndaluar aksesin e paautorizuar sipas Rregullore nr. 37.

16.3 Pas fillimit të ofrimit të rrjetit dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, AKEP kryen verifikimin e zbatimit nga sipërmarrësi të masave mbrojtëse për të ndaluar ksesin e paautorizuar sipas dokumentit të depozituar në AKEP.

17. Përdorimi i frekuencave:

17.1 Dhënia në përdorim dhe përdorimi i frekuencave bëhet nga AKEP në përputhje me përcaktimet e parashikuara në ligjin nr. 9918, Planin Kombëtar të Frekuencave të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 466, datë 27. 2. 2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave” (*VKM nr. 466*), si dhe Planin e Përdorimit të Frekuencave , miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1490, datë 17. 01. 2011, si dhe aktet e ITU dhe ECA – Tabela për Përcaktimin e Përbashkët European të Frekuencave.

17.2 Personat fizikë apo juridikë mund të përdorin frekuenca vetëm pasi të jenë pajisur, paraprakisht, me autorizim nga AKEP sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9918 dhe Rregullore nr. 30, datë 05. 12. 2013 “Për dhënien e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave” (**Rregullore nr. 30**).

17.3 E drejta e përdorimit të frekuencave kufizohet vetëm në rast se kjo kushtëzohet nga pamjaftueshmëria e frekuencave dhe nga detyrimi për të siguruar përdorimin eficient të tyre.

17.4 Për përdorimin e frekuencave të caktuara në PKF, për qëllime të sigurisë kombëtare dhe mbrojtjes së vendit, nuk do të kërkohet autorizim nga AKEP.

17.5 Disa frekuenca mund të përdoren pa autorizim, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9918, rregullat e ITU dhe Rregullore nr. 33, datë 15. 05. 2014 “Për kushtet e përdorimit të frekuencave të pa autorizim individual dhe kërkesat teknike për pajisjet radio që përdoren në këto breza” (**Rregullore nr. 33**).

17.6 Kur përdorimi i frekuencave nuk është subjekt i autorizimit të përgjithshëm, sipas pikës 5 të ligjit nr. 9918 dhe Rregullore nr. 33, apo subjekt i një konkurrimi publik, sipas neneve 68 e 69 të këtij ligji, AKEP lëshon autorizime individuale, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 dhe Rregullore nr. 30.

17.7 Kur përdorimi i frekuencave është subjekt i një konkurrimi publik sipas nenit 68 dhe 69 të ligjit nr. 9918, frekuencat jepen nga AKEP në përputhje me procedurën e përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1252, datë 10. 09. 2008 “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave” të ndryshuar (**VKM nr. 1252**).

17.8 Kushtet, që duhet të plotësohen nga përdoruesi, për shfrytëzimin e frekuencave, zbatohen edhe për shërbimet e komunikimeve elektronike, ose rrjetet e komunikimeve elektronike, për të cilat janë dhënë frekuencat.

17.9 Sipërmarrësit zbatojnë kushtet e shfrytëzimit të frekuencave të vendosura nga AKEP për:

- a) masat, për të siguruar përdorimin eficient të frekuencave dhe, ku është e nevojshme, detyrimet për mbulimin dhe fortësinë e sinjalit (fuqinë e transmetimit);
- b) kushtet teknike të funksionimit, të nevojshme për shmangien e interferencave të dëmshme dhe kufizimin e ekspozimit të publikut ndaj fushave elektromagnetike;
- c) afatin e vlefshmërisë së përdorimit të frekuencave;
- ç) transferimin e të drejtave të pronësisë për përdorimin e frekuencave dhe kushtet për transferim;
- d) kryerjen e pagesave;
- e) detyrime të tjera, të marra përsipër nga fituesi gjatë pjesëmarrjes në tenderin publik si dinamika e ngritjes së rrjetit, zonat e mbulimit, etj.;
- f) detyrime për aktet dhe marrëveshjet ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë;
- g) detyrime nga marrëveshjet e lidhura nga AKEP me organet rregullatore të vendeve fqinje për shmangien e interferencave në zonat kufitare; etj.

17.10 Ndalohet transferimi i së drejtës për përdorimin e frekuencës në një sipërmarrës tjetër, në rast se për këtë nuk është dhënë, paraprakisht, miratimi nga AKEP. Miratimi mund të jepet vetëm kundrejt kërkesës me shkrim nga mbajtësi i autorizimit.

17.11 Autorizimi individual për përdorimin e frekuencave mund të ndyshohet nga AKEP me nismën e vet ose kërkesën e mbajtësit të tij, në rastet e përcaktuara në nenin 75 të ligjit nr. 9918.

17.12 Autorizimi individual për përdorimin e frekuencave mund të revokohet nga AKEP me nismën e vet ose kërkesën e mbajtësit të tij, në rastet e përcaktuara në nenin 76 të ligjit nr. 9918.

17.13 Me kërkesë të mbajtësit të autorizimit individual, vlefshmëria e autorizimit mund të shtyhet vetëm në rast se në përfundim të këtij afati janë përmbushur të gjitha kushtet e përdorimit të këtyre frekuencave.

Rregullat dhe procedura për rinovimin e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave përcaktohen në vendimin e këshillit të Ministrave nr. 496, datë 22. 7. 2014 “Për miratimin e rregullave e të procedurave të rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim” (**VKM nr. 496**).

17.14 Për shmangien e interferencave të frekuencave sipërmarrësit zbatojnë rregullat e përcaktuara në Rregulloren e AKEP nr. 35, datë 23. 12. 2014 “Për administrimin e interferencave” (**Rregullore nr. 35**).

17.15 Çdo sipërmarrës:

a) është i detyruar të përdori gjatë ndërtimit të rrjetit dhe ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike, pajisje radio të prodhuara në mënyrë të tillë që të lejojnë përdorim efektiv të spektrit që i është caktuar, me qëllim që të shmangi çdo interferencë të dëmshme.

b) është i detyruar të bashkëpunojë me cilindo sipërmarrës tjetër që përdor radiofrekuenca të caktuara nga AKEP-i, në mënyrë që të eliminohet çdo interferencë e dëmshme që mund të preki cilësinë e shërbimeve të komunikimeve elektronike që i ofrohen përdoruesve, ose të eliminojë çdo interferencë të dëmshme që mund t’ju jetë shkaktuar stacioneve të radiokomunikimit që operojnë në mënyre legale brenda territorit të Shqipërisë ose në vendet fqinje.

Nëqoftëse AKEP konstaton se një interferencë e dëmshme është shkaktuar tek stacionet e radiokomunikimit ose përdoruesit për shkak të moszbatimit të kushteve dhe specifikimeve të frekuencave të caktuara, ose për shkak të keqfunksionimit të pajisjeve të tij, sipërmarrësi është i detyruar të ndërpresë funksionimin e sistemit të tij, menjëherë pas marrjes së njoftimit. Në rast të kundërt, ndaj tij aplikohen sanksionet e parashikuara nga ligji nr. 9918.

17.16 Cilido sipërmarrës është i detyruar të zbatojë standardet e pajisjeve të përcaktuara nga autoritetet kompetente shqiptare dhe ETSI në lidhje me këto pajisje, si dhe kriteret përkatëse të përcaktuara nga AKEP-i lidhur me karakteristikat e transmetimit, në mënyrë të tillë që të sigurojë bashkëzistencën efektive dhe të harmonizuar të të gjithë aplikimeve të telekomunikacioneve pa tela në të njëjtën frekuencë apo në frekuenca fqinje. Sipërmarrësi duhet të zbatojë kushtet teknike të vendosura në autorizimin individual me të cilin është pajisur.

17.17 Cilido sipërmarrës duhet të sigurojë që rrjeti i tij është projektuar, instaluar, mirëmbajtur dhe funksionon në mënyrë të tillë që të mos shkaktojë çfarëdo interference të dëmshme ndaj sipërmarrësve të tjerë ose përdoruesve të ligjshëm të spektrit të frekuencave.

17.18 AKEP monitoron përdorimin e frekuencave në përputhje me Rregulloren nr. 44, datë 13. 101. 2016 “Për monitorimin e spektrit të frekuencave” dhe zbaton sanksionet e parashikuara në ligjin nr. 9918 në rast të përdorimit të tyre në kundërshtim me ligjin nr. 9918, aktet nënligjore dhe rregullatore, si dhe autorizimit individuale të lëshuara nga AKEP për këtë qëllim.

17.19 Mbajtësit e të drejtave për përdorimin e frekuencave paguajnë pranë AKEP një pagesë vjetore për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, neni 119 i ligjit 9918. Niveli i pagesës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Fituesi së drejtës për përdorimin e frekuencave, që jepet me procedurën e konkurimit publik, sipas nenit 69 të ligjit nr. 9918, kryen një pagesë për frekuencat në vlerën e arritur në procesin e konkurimit, e cila derdhet në Buxhetin e Shtetit (pika 9 e nenit 68 të ligjit nr. 9918).

17.20 Subjektet që pajisen nga AKEP me autorizim individual për përdorimin e frekuencave në sistemet radio private të lëvizshme, nuk janë subjekte të zbatimit të kushteve të përgjithshme të përcaktuara në këtë rregullore.

17.21 Subjektet që pajisen nga AKEP me autorizim individual për përdorimin e frekuencave në sistemet radio private të lëvizshme, regjistrohen nga AKEP në një regjistër të veçantë “*data base*”

dhe janë të detyruar të zbatojnë kushtet e veçanta të përcaktuara në ligjin nr. 9918, Rregulloren nr. 30, Rregulloren nr. 35 dhe autorizimin individual për përdorimin e frekuencave në përputhje me kushtet e shfrytëzimit të këtyre frekuencave.

18. Detyrimi i plotësimit të standardeve dhe specifikimeve teknike të rrjeteve dhe të pajisjeve:

18.1 Cilido sipërmarrës që ofron rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike duhet të zbatojë standardet dhe kërkesat teknike të përcaktuara nga AKEP mbi bazën e ligjit nr. 9918, VKM nr. 546, Rregullore nr. 16, datë 16. 04. 2010 “Për treguesit e cilësisë së shërbimeve” (**Rregullore nr. 16**), Rregullore nr. 22 dhe Rregullore nr. 25.

18.2 Standartet e aplikuara në Treguesit e Cilësisë së Shërbimit (QoS) janë:

ETSI	EG	202	057	
ETSI:	EG	202	057-1	V1.1.1
ETSI:	EG	202	057-1	V1.2.1
ETSI:	EG	202	057-2	V1.2.1
ETSI:	EG	202	057-3	V1.1.1
ETSI:	EG	202	057-4	V1.1.1
ETSI	EG	201	769.	
ETSI	EG	201	769-1.	
ETSI	EG	201	769-1	V1.1.2
ETSI	TR	101	949	
ETSI	TS	102	250-5	
ETSI-Specifikime Teknike	-TS	102	250-6.	
Raporti teknik ETSI	TR	101	949	

Standartet RTTE
Technical report ETSI TR101949

18.3 Kur standardi teknik i rrjeteve dhe pajisjeve nuk pasqyrohet në aktet ligjore, nënligjore apo ato rregullatorë të AKEP, janë të zbatueshme standardet e miratuara dhe rekomanduara nga institucionet ndërkombëtare ITU, ISO ose Electrotechnical Commission (IEC).

18.4 Të gjithë subjektet/sipërmarrësit të cilët ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike në tregjet e pa rregulluara të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, janë të detyruar të zbatojnë standardet teknike dhe treguesit e cilësisë (QoS) në përputhje me ligjin nr. 9918, këtë Rregullore dhe aktet rregullatore të nxjerra nga AKEP për këtë qëllim.

19. Detyrimet për transparencë dhe informim për kufizimet e aksesit ose të përdorimit të shërbimeve, aplikimeve në rastin e zbatimit të tyre:

19.1 Transparenca dhe publikimi i informacionit nga sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe komunikime elektronike publike mbi kushtet e ofrimit të shërbimeve në tregun e pakicës për

pajtimtarët dhe shërbimeve në nivel shumice, përbën detyrim ligjor dhe sipërmarrësit detyrohen të zbatojnë përcaktimet e parashikuara në ligjin nr. 9918, aktet nënligjore dhe ato rregullatore për këtë qëllim.

19.2 Sipërmarrësit që ofrojnë rrjete të komunikimeve publike dhe/ose shërbime telefonike të disponueshme për publikun janë të detyruar të publikojnë në faqen elektronike të tyre informacionin e përcaktuar në nenin 98 të ligjit nr. 9918 dhe Rregulloren nr. 27 lidhur me:

- a) emrin dhe adresën e sipërmarrësit;
- b) fushëveprimin e shërbimit të ofruar dhe gatishmërinë gjeografike të shërbimeve (zona e mbulimit me shërbime);
- c) tarifatat standarde, të cilat tregojnë shërbimet e ofruara dhe përmbajtjen e secilit element të tarifave (p.sh. detyrimet për akses, të gjitha llojet e detyrimeve për përdorimin, detyrimet për mirëmbajtje), duke përcaktuar detajet e zbritjeve standarde të aplikuara, planet tarifore speciale e të orientuara, çdo detyrim shtesë, si dhe kostot lidhur me pajisjet fundore;
- ç) politikat e kompesimit/rimbursimit, përfshirë hollësitë specifike të çdo plani të ofruar për kompesim/rimbursim;
- d) llojet e ofruara të shërbimit të mirëmbajtjes;
- e) kushtet e përgjithshme të kontratës Tip, duke përfshirë periudhën minimale kontraktuale, përfundimin e kontratës, procedurat dhe detyrimet e drejtpërdrejta të lidhura me portabilitetin e numrit dhe tregues të tjerë të përcaktuara nga AKEP në Rregulloren nr. 31;
- f) mekanizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të parashikuara në nenin 107 dhe 120/1 të ligjit nr. 9918 dhe Rregulloren e AKEP nr. 29, datë 20. 05. 2013 “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet pajtimtarëve dhe sipërmarrësve të komunikimeve elektronike” (Rregullore nr. 29);
- g) të drejtat me shërbimin universal, etj.

19.3 Sipërmarrësit që ofrojnë rrjete të komunikimeve publike dhe/ose shërbime telefonike të disponueshme për publikun janë të detyruar:

- a) t’u ofrojnë pajtimtarëve informacion për tarifatat e aplikueshme për çdo numur ose shërbim, subjekt i kushteve të veçanta të tarifimit dhe për kategoritë individuale të shërbimeve ky informacion të ofrohet menjëherë para lidhjes së thirrjes;
- b) të informojë pajtimtarët për çdo ndryshim të aksesit në shërbimet e emergjencës ose të informacionit për vendndodhjen e numrit thirrës në shërbimin ku janë pajtuar;
- c) të informojnë pajtimtarët për çdo ndryshim të kushteve që kufizojnë aksesin në, dhe/ose përdorimin e shërbimeve dhe aplikimeve dhe ku këto shërbime janë të lejueshme sipas ligjeve në fuqi;
- d) të ofrojnë informacion për çdo procedurë të vendosur nga ofruesi, në mënyrë që të masë dhe drejtojë trafikun, për të evituar nga rkesën ose mbingarkesën e lidhjeve të rrjetit dhe si këto procedura mund të ndikojnë në cilësinë e shërbimit;
- e) të informojnë pajtimtarët për të drejtën e tyre për të vendosur për të përfshirë ose jo të dhënat e tyre personale në numrator, si dhe llojin e të dhënave, në përputhje me nenin 104 të ligjit nr. 9918;
- f) të informojnë rregullisht pajtimtarët me aftësi të kufizuara për detajet e produkteve dhe shërbimeve të projektuara për ata.

19.4 Sipërmarrësit, që ofrojnë akses në rrjetet e komunikimeve elektronike publike, mund ta kufizojnë ose ndërpresin përkohësisht aksesin në shërbimet e tyre, pa miratimin paraprak të përdoruesve, në se kjo është e nevojshme për përmirësimin, modernizimin, mirëmbajtjen apo probleme teknike në rrjet.

19.5 Sipërmarrësit duhet të vënë në dijeni AKEP dhe përdoruesit për kufizimet apo ndërprerjet e shërbimit, të cilat do të zgjasin më shumë se 30 min. Ky njoftim bëhet:

a) të paktën 48 orë më parë, në rast të një përmirësimi, modernizimi ose mirëmbajtje të planifikuar të rrjetit;

b) sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 48 orë, pas ndodhjes së kufizimit apo ndërprerjes së shkaktuar nga defekte apo dëmtime të rrjetit.

19.6 Sipërmarrësit duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme që ta bëjnë sa më të shkurtër kohën e kufizimit ose ndërprerjes.

19.7 Sipërmarrësit mund ta kufizojnë aksesin shërbimet e tyre dhe/ose mund ta ndërpresin lidhjen e pajtimtarit, apo mund të ndërpresin kontratën me pajtimtarin vetëm në rast se pajtimtari nuk përmbush kushtet e kontratës, apo nuk kryen pagesat, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

19.8 Sipërmarrësit duhet të përcaktojnë qartë dhe me detaje kushtet e kontratës rastet kur bëhet kufizimi, ndërprerja e shërbimit apo ndërprerja e kontratës.

19.9 Nëse është e mundur teknikisht, operatorët që janë të detyruar të kufizojnë aksesin vetëm për ato shërbime që pajtimtari ka shkelur kushtet e kontratës, përveç rasteve kur pajtimtari abuzon, ose, në mënyrë të përsëritur, kryen me vonesë ose nuk paguan faturat.

19.10 Ndalohet të kufizohet aksesin për përdorimin e numrave të emergjencës.

19.11 Pajtimtari i Aksesit në Internet duhet veçanërisht të njoftohet me mjete elektronike (si p.sh. SMS, mesazh në PC, telefon) kur arrihet niveli 80% i kufizimit “doëload/upload” (nëse ka të tillë). Sipërmarrësi mund të kufizojë shpejtësinë e Aksesit në Internet pas kalimit të kufizimit doëload/upload, për të reduktuar mundësinë e shpenzimeve shumë të larta për pajtimtarin pas tejkalimit të kuotës/limitit

20. Detyrimi për lejimin e inspektimit:

20.1 Zbatimi i kushteve të përgjithshme dhe/ose të veçanta nga sipërmarrësi, përbën objekt të mbikëqyrjes, kontrollit dhe monitorimit nga AKEP në mbështetje të kompetencës ligjore të përcaktuar në nenin 8 të ligjit nr. 9918 në kuadër të ushtrimit të inspektimit të veprimtarisë sipas këtij ligji, Rregullores së AKEP nr. 46, datë 27. 10. 2016 “Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike” (**Rregullore nr. 46**), dhe Rregullore nr. 44, datë 13. 10. 2016 “Për monitorimin e spektrit të frekuencave” (**Rregullore nr. 44**).

20.2 Sipërmarrësi ose çdo person tjetër, fizik apo juridik, që zhvillon veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike, është i detyruar t’i lejojë inspektorët e AKEP të kryejnë inspektimin kudo ku ka pajisje të komunikimeve elektronike, si dhe t’i ofrojnë inspektorëve të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e kërkuar prej tyre, në përputhje me Rregulloren nr. 46.

20.3 Kur inspektorët e AKEP vërtetojnë se një sipërmarrës i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike ose çdo person tjetër fizik apo juridik, që ushtron veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike, ka shkelur ligjin nr. 9918, dhe rregulloret e nxjerra nga AKEP në zbatim të tij, përbën kundërvajtje administrative dhe AKEP zbaton masat administrative të përcaktuara në këtë ligj.

21. Detyrimi i kryerjes së pagesave në AKEP dhe gjobave:

21.1 Sipërmarrësit dhe çdo person fizik apo juridik i cili ushtron veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm është i detyruar të kryejë në AKEP pagesat e përcaktuara në ligjin nr. 9918, aktet nënligjore në zbatim të tij dhe aktet rregullatore të AKEP.

21.2 Pagesat që kryhen në AKEP janë:

a) **Pagesa për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike:**

Sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimit, janë të detyruar të paguajnë një pagesë vjetore për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike nga AKEP-i. Kjo pagesë nuk duhet të jetë më shumë se 0,5 % e së ardhurës vjetore të vitit kalendarik të mëparshëm dhe duhet të realizohet brenda datës 30 prill të çdo viti. Procedura dhe mënyra e llogaritjes përcaktohen në rregullore nr. 20, datë 28. 12. 2015 “Për procedurën dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare.

- b) **Pagesa për caktimin dhe përdorimin e frekuencave.**
- c) **Pagesa për caktimin dhe përdorimin e kodeve, numrave dhe të serive numerike.**
- ç) **Pagesa për financimin e shërbimit universal.**
- d) **Pagesa për tarifën e shërbimit të radiokomunikacionit.**

Në bazë të Ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe AKEP, Nr. 28, datë 06.10.2008, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e radiokomunikacionit” i ndryshuar, AKEP është agjent tatimor për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në Buxhetin e Shtetit të tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit.

e) **Pagesa për portabilitetin e numrit:**

Në bazë të nenit 87, të ligjit nr. 9918/2008 dhe nenit 20 të Rregullores nr. 43, datë 22.9.2016 “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit” operatorët janë të detyruar të kryejnë pagesën e llogaritur nga AKEP, për mbulimin e kostove financiare të ofrimit të shërbimit të operatorit të CRDB si dhe hostimit të platformës.

21.3 Moskryerja e plotë dhe në afat e pagesave përbën kundërvajtje administrative dhe është e dënueshme në përputhje me përcaktimet ligjore të parashikuara në nenin 137 të ligjit nr. 9918.

Moskryerja e plotë dhe në afat e pagesave për caktimin dhe përdorimin e frekuencave dhe numeracionin përveçse është e dënueshme me gjobë, çon edhe në revokimin nga AKEP të autorizimeve individuale për dhënien e të drejtës së përdorimit të tyre.

21.4 Sipërmarrësit, të cilët sipas ligjit nr. 9918 dhe Rregullores nr. 46 të AKEP janë gjobitur nga inspektorët për kundërvajtje administrative, në përputhje me përcaktimet ligjore janë të detyruar të ekzekutojnë pagesën e gjobës brenda afatit. Gjoha sipas ligjit nr. 10 279, datë 20. 5. 2010 “Për kundërvajtjet administrative”, është titull ekzekutiv.

III DISPOZITA TË VEÇANTA:

1. Detyrime Shtesë lidhur me Ofrimin e Shërbimeve Publike Telefonike fikse:

Dispozitat e mëposhtme kanë të bëjnë me detyrime shtesë që ju vendosen sipërmarrësve që ofrojnë shërbime publike telefonike fikse. Kështu, çdo sipërmarrës që vepron nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm dhe ofron Shërbime Publike Telefonike fikse është i detyruar të zbatojë këto dispozita.

1.1 Detyrime lidhur me vendosjen e telefonave publikë:

1.1.1 Çdo sipërmarrës që vepron nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm dhe vendos telefona publikë është i detyruar të zbatojë dispozitat e mëposhtme.

1.1.2 Për qëllim të kësaj dispozite, telefonat publikë janë ata që janë instaluar në mënyrë të përherëshme në vende publike ku aksesimi është i mundur 24 orë.

1.1.3 Çdo sipërmarrës që ofron telefona publikë duhet të sigurojë mundësinë e thirrjes së numrave të emergjencës pa pagesë dhe pa mjet pagese.

1.1.4 Sipërmarrësi, është përgjegjës për instalimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e këtyre telefonave.

Sipërmarrësi që ofron telefona publikë duhet të sigurojë shërbime telefonike dhe, në mënyrë të veçantë, shërbimet vijuese:

- a) Akses në numerorët telefonikë në mënyrë të tillë që gjithë shërbimet e informacionit që ofrohen nëpërmjet serive 118XX të mundësohen nga të gjithë telefonat publikë, nëse një gjë e tillë është teknikisht e mundur.
- b) Akses pa pagesë në shërbimet e emergjencës pa përdorim karte apo monedhe.
- c) Akses në shërbimet e postës zanore.

1.1.5 Sipërmarrësit janë të detyruar të tregojnë informacionin vijues, në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe lehtësisht të dallueshme, në zonën ku janë instaluar telefonat:

- a) Informacion mbi pagesat e bëra dhe mënyrat e e pagimit për shërbimet në fjalë. Duhet të ketë një informim të mjaftueshëm dhe të qartë për çmimet individuale që zbatohen për destinacionin dhe kohën kur është bërë thirrja. Përveç kësaj, duhet të ketë informim të qartë mbi nivelin e tarifimit dhe tarifën minimale.
- b) Duhet të tregohet mundësia e kryerjes së thirrjeve të emergjencës.
- c) Duhet të tregohet mundësia e marrjes të thirrjeve hyrëse.

1.1.5 Numri i kontaktit nëse ka ankesa ose probleme. Sipërmarrësit që ofrojnë shërbime publike të komunikimeve elektronike duhet të sigurojnë akses për përdoruesit me aftësi të kufizuar, duke bërë lehtësisht të disponueshëm përfitimin e shërbimeve të tyre nga këta të fundit, si dhe të informojnë këtë kategori përdoruesish për detajet e produkteve dhe shërbimeve të projektuara për ata.

1.1.6 Sipërmarrësi që ofron telefona publikë duhet të sigurojë që 75% e telefonave publikë të jenë të aksesueshëm nga personat aftësi të kufizuara.

Sipërmarrësi që ofron telefona publikë duhet të konsultohet me AKEP mbi specifikimet e telefonave publikë që ai ka ndërmend të instalojë, në mënyrë që të sigurojë që çështjet lidhur me personat me aftësi të kufizuara të merren në konsideratë në instalimin dhe ofrimin e telefonave publikë.

2. Detyrime lidhur me ofrimin e shërbimeve të informacionit multimedialë:

2.1 Dispozitat e mëposhtme i takojnë detyrimeve shtesë që u vendosen sipërmarrësve që ofrojnë Shërbime të Informimit Multimedialë. Ky shërbim përfshin Audiotekstin dhe Videotekstin, mesazhet e shkurtër me vlerë të shtuar (SMS) dhe mesazhet multimedialë me vlerë të shtuar (MMS). Kështu, çdo sipërmarrës që punon nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm dhe ofron shërbime informimi multimedialë është i detyruar të zbatojë dispozitat e mëposhtme:

2.2 T'ju japë përdoruesve informacion të mjaftueshëm mbi tarifatat për shërbimet e informacionit multimedial. Përpara ofrimit të shërbimit, në fillimin e thirrjes, ata janë të detyruar të sigurojnë, nëpërmjet një mesazhi të regjistruar, pa pagesë për përdoruesit, një përshkrim të qartë të tarifave të aplikueshme dhe, në varësi të rastit, nëse shuma totale paguhet pavarësisht nga kohëzgjatja e thirrjes, apo shuma që paguhet llogaritet me njësi kohore si dhe pagesën rezultuese për minutë, duke përfshirë Taksën e Vlerës së Shtuar (TVSH).

2.3 Në mënyrë më specifike, lidhur me mesazhet e shkurtër me vlerë të shtuar (SMS) dhe mesazhet multimedialë me vlerë të shtuar (MMS), ofruesit janë të detyruar të informojnë çdo përdorues menjëherë mbas transmetimit të mesazhit të parë, rreth tarifave për mesazh, numrin

total të mesazheve që kërkohen për ofrimin e shërbimit, kur është e mundur, dhe koston maksimale totale të shërbimit për përdorues, duke përfshirë TVSH korresponduese.

2.4 Të mos tarifoje konsumatorët për kohën që ata humbasin duke pritur të lidhen me shërbimin ose, në se është teknikisht e mundur, të mos i përgjigjet një thirrjeje të konsumatorit kur nuk ka linjë të disponueshme për ofrimin e shërbimit.

2.5 Gjatë reklamimit promovues të shërbimeve, tarifat duhet të përshkruhen qartë në përputhje me dispozitën e mësipërme për mesazhin e regjistruar, ata duhen shkruar qartë dhe horizontalisht, dhe duhen treguar në çdo sipërfaqe promocionale në rastet e reklamave te shtypura, apo multimediale, ose ata duhen prezantuar qartë, në varësi të rastit për minutë, për thirrje ose për mesazh, së bashku me numrin maksimal të mesazheve që kërkohen për ofrimin e shërbimit, kur përdoret promovim zanor nëpërmjet një mediumi elektronik apo mediumi tjetër. Në rastin e reklamave multimediale tarifat duhen shkruar në përputhje me kërkesat e mësipërme gjatë gjithë kohëzgjatjes së një reklame në pozicion fiks dhe jo në shirit të lëvizshëm.

2.6 Të vendosë në funksionim një linjë ankesash, pa asnjë pagesë shtesë, e cila ka të bëjë me njoftimet – reklamat të lidhura me shërbimin në fjalë.

2.7 Të mos lejojë thirrje më të gjata se 15 minuta.

3. Detyrime lidhur me ofrimin e kartave të parapaguara:

3.1 Ofruesit e kartave të parapaguara janë të detyruar të sigurojnë, së bashku me kartat, një fletë informacionesh që përmban gjithë informacionin për tarifën, siç përshkruhet në paragrafin vijues ose të vënë në funksionim një qendër telefonike, që siguron pa pagesë, informacion të detajuar mbi tarifën.

3.2 Informacioni që duhet siguruar për tarifën duhet të tregojë mjaftueshëm dhe qartë, informacionin e mëposhtëm:

- a) çmimet individuale që zbatohen në çdo rast ndaj shërbimeve përkatëse sipas tipit të rrjetit;
- b) nivelin e tarifimit, pagesën minimale ose pagesën për përgjigjen ndaj thirrjes, në se ka të tillë;
- c) uljet që zbatohen zakonisht;
- ç) datën e përfundimit të vlefshmërisë të kartës.
